

**MARRËVESHJE PËR BLERJE TË ENERGJISË PËR KAPACITETET GJENERUESE
NGA BURIME E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË MBËSHTETUR NGA
RREGULLA PËR SKEMËN MBËSHTETËSE**
[Lloji i Burimit të Ripërtëritshme të Energjisë]

[Ky shabllon është miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, ashtu siç kërkohet nga Rregulla për Skemën Mbështetëse për të nxitur ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtëritshme]

DATE [•]

KOSTT, SH.A.

-DHE-

[emri i gjeneratorit •]

PËRMBAJTJA

MARRËVESHJE PËR BLERJE TË ENERGJISË.....	4
1. INTERPRETIMI DHE PËRKUFIZIMET.....	5
2. FILLIMI DHE AFATI.....	13
3. BLERJA DHE SHITJA E ENERGJISË ELEKTRIKE.....	14
4. PAGESA E ENERGJISË	15
5. KYÇJA.....	16
6. MATJA	16
7. TELEKOMUNIKIMET	18
8. FATURIMI DHE PAGESA	19
9. MOSMARRËVESHJET PËR PAGESË.....	20
10. PROGRAMI PËR TESTIME	21
11. DISPONUESHMËRIA DHE KOMISIONIMI I NJËSISË GJENERUESE.....	21
12. PARASHIKIMI I NETO ENERGJISË ELEKTRIKË TË LIFERUAR.....	23
13. UDHËZIMET E DISPEÇIMIT.....	24
14. NDËRPRERJA E PLANIFIKUAR.....	24
15. NDËRPRERJET PËR MIRËMBAJTJE	25
16. PUNËSIMI I PERSONELIT TË KUALIFIKUAR.....	25
17. MIRËMBAJTJA E REGJISTRAVE TË OPERIMIT	26
18. NGJARJET E MOS PËRMBUSHJES NGA PRODHUESI	27
19. NGJARJET E MOS PËRMBUSHJES NGA BLERËSI	28
20. NJOFTIMI PËR QËLLIMIN E SHKËPUTJES.....	29
21. NJOFTIMI PËR SHKËPUTJE	29
22. OBLIGIMET PAS SHKËPUTJES	30
23. TRANSFERIMI	30
24. MBAJTJA E POLICAVE TË SIGURIMIT.....	31
25. DËMSPËRBLIMI DHE PËRGJEGJËSIA.....	31
26. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIONET.....	33

27.	TATIMET	36
28.	POHIMI	36
29.	NUK KA PËRGJEGJËSI PËR TË RISHQYRTUAR	37
30.	FSHEHTËSIA.....	37
31.	NJOFTIMET	37
32.	PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME	38
33.	HEQJA DORË	39
34.	FORCA MADHORE	39
35.	NDRYSHIMET.....	42
36.	PALËT E TRETA	42
37.	MARRËVESHJA E PLOTË	42
38.	LIGJI QEVERISËS	42
39.	ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE.....	42
40.	MARRËDHËNIET E PALËVE.....	43
41.	GJUHA.....	43
42.	KOPJET	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
	SHTOJCA 1 TARIFAT PËR BLERJE TË ENERGJISË.....	45
	SHTOJCA 2 PËRSHKRIMI I KOMPLEKSIT	46
	SHTOJCA 3 PIKA KYÇËSE	47
	SHTOJCA 4 SIGURIMI	48
	SHTOJCA 5 KUFIZIMET TEKNIKE; PROGRAMI & TESTET E KOMISIONIMIT.....	49

MARRËVESHJE PËR BLERJE TË ENERGJISË

KJO MARRËVESHJE është hartuar dhe lidhur me [data ●], nga dhe në mes të:

- (1) **Operatorit të Transmisionit dhe të Tregut - KOSTT SH.A.** një kompani e inkuorporuar sipas ligjeve të Kosovës, e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji si Operator i Tregut me numrin e regjistruar 70325350 zyra e regjistruar e të cilit është në Rr. Iljaz Kodra, p.n. , Prishtinë, Kosovë (në tekstin në vazhdim “**Blerësi**”).

DHE

- (2) [**emri i gjeneratorit**] një kompani e inkuorporuar sipas ligjeve të [vendi] me numrin e regjistruar [●] zyra e regjistruar e të cilit është në [●] (në tekstin në vazhdim “**Prodhuesi**”).

(secila ndaras “**Palë**” dhe së bashku “**Palët**”)

PALËT SHPREHEN

- A.** [SE, Prodhuesi është i autorizuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (siç është e definuar këtu) me vendimin e saj [●] për të ndërtuar [*Llojin e Burimit të Energjisë së Ripërtëritshme*]] stabiliment të gjenerimit të energjisë elektrike, dhe është pranuar për mbështetje të burimeve të energjisë së ripërtëritshme sipas Rregullës për Skemën Mbështetëse (siç përcaktohet këtu)];
- B.** [SE, Prodhuesi ka dizajnuar, projektuar, dhe ndërtuar [●]stabilimentin gjenerues të energjisë elektrike (“Gjeneratori” (siç përcaktohet këtu)) në “Vendndodhja” (siç përcaktohet këtu) në Komunën e [●] që ka një kapacitet të vlerësuar nominal prej [●] MW (bruto)];
- C.** [SE, prodhuesi ka finalizuar marrëveshjen për kyçje me KEDS[KOSTT] sipas Marrëveshjes për Kyçje për [Rrjetin e Transmisionit të Kosovës ose] rrjetin e Shpërndarjes së Kosovës dhe ndryshimet e tij];
- D.** [SE, Prodhuesi dëshiron të shesë dhe Blerësi ka rënë dakord, bazuar në obligimet e tij sipas Nenit 8.1 dhe 23.9 (nënparagrafi 9.8) të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085 dhe Rregullës për Skemën Mbështetëse, të blej të gjithë Neto Energjinë Elektrike të Liferuar (siç përcaktohet këtu), sipas dhe në pajtim me termat dhe kushtet e përfshira këtu];
- E.** [SE, Ligji për Energjinë Elektrike, dhe Rregulla për Skemën Mbështetëse detyron Blerësin të blejë energjinë që gjenerohet nga burimet e ripërtëritshme e cila përmban certifikatën e origjinës dhe të përcaktuar sipas Rregullës për Skemën Mbështetëse dhe i jep të drejtën e dispeçimit me prioritet gjeneratorit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme (siç përcaktohet këtu)];

- F.** [SE, Blerësi ka marrë përsipër obligimet në këtë Marrëveshje, në përputhje me Legjislacionin në Kosovë, me qëllim për të nxitur ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese BRE në Republikën e Kosovës, të përfshira në Rregullën për Skemën Mbështetëse];
- G.** [SE, Rregulla për Skemën Mbështetëse obligon Blerësin që të jetë Palë Përgjegjëse Balancuese për të gjithë prodhuesit BRE të pranuar në Skemën Mbështetëse dhe Kornizën Rregulluese]

TANI, duke pasur parasysh kushtet e mësipërme dhe duke marrë parasysh përfitimet reciproke që rrjedhin nga kjo dhe përfaqësimet dhe garancitë, kontratat dhe marrëveshjet e përfshira këtu, dhe në rrethana tjera të mira dhe të vlefshme, mjaftueshmëria e të cilave është pranuar në këtë mënyrë, dhe me qëllim që të ketë detyrim ligjor, Palët pajtohen si në vijim:

1. INTERPRETIMI DHE PËRKUFIZIMET

Sa herë që shprehjet e mëposhtme me germa të mëdha të shfaqen në këtë Marrëveshje ose në Shtojca, ato do të kenë kuptimet e cekura më poshtë:

- 1.1 **“Braktisje”** – Ndërprerja vullnetare e operimit të Gjeneratorit, dhe tërheqja e të gjithë, ose kryesisht të gjithë, personelit nga vetë Prodhuesi nga Vendndodhja për arsye tjera q; nuk janë (i) një shkëlqje ose mosplotësim i zotimeve nga Blerësi sipas kësaj Marrëveshje ose (ii) Ngjarje e Forcës Madhore.
- 1.2 **“Marrëveshje”** do të thotë kjo Marrëveshje për Blerje të Energjisë duke përfshirë të gjitha Shtojcat e shkruara, ndryshimet dhe shtesat për të cilat Palët mund të lidhin marrëveshje kohë pas kohe.
- 1.3 **“Viti i Marrëveshjes”** – Çdo periudhë prej dymbëdhjetë (12) Muajsh të njëpasnjëshëm, duke filluar nga Data e Operimeve Komerciale dhe në çdo përvjetor pas tij dhe duke përfunduar në fund të Ditës menjëherë para secilit përvjetor pasues të Datës së Operimeve Komerciale deri në skadim të Afatit, apo Datës së Shkëputjes së Hershme.
- 1.4 **“Anëtarët e Organizatës”** – Çdo Person që direkt apo indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve kontrollon, ose kontrollohet nga, ose është nën kontroll të përbashkët me një Person tjetër.
- 1.5 **“Nen”** do të thotë Nen në këtë Marrëveshje.
- 1.6 **“Data e Disponueshmërisë”** – Dita pas Ditës kur Deklarata e Disponueshmërisë është lëshuar sipas Nenit 11.1.
- 1.7 **“Balancimi”** do të thotë operimet dhe proceset dhe procedurat në kohë reale që operatori i sistemit të transmisionit do të përdorë për të balancuar sistemin, që përfshinë por nuk kufizohet në rrjedhat aktive të energjisë, kontrollin e frekuencës dhe kontrollin e tensionit dhe energjisë reaktive.
- 1.8 **“Ditë Bankare në Bruksel”** – Çdo ditë përveç të shtunës ose të dielës ose çdo ditë tjetër në të cilën bankat janë të mbyllura në Bruksel, Belgjikë.

- 1.9 **“Ditë Pune”** – Do të thotë çdo ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë në Prishtinë, Kosovë dhe veçanërisht duke përfshirë të shtunat, dielat dhe festat Qeveritare.
- 1.10 **“Vendi”** do të thotë Republika e Kosovës.
- 1.11 **“Kushtet Klimatike”** – do të thotë kushtet e motit, natyra e të cilave ndikon në operim dhe gjenerim të Gjeneratorit, që ekziston në Vendndodhje. (kjo është shpejtësia e erës, ndërprerja e erës, norma volumetrike e derdhjes së ujit, nivelet e rrjedhës së sipërme dhe poshtme të ujit, rrezatimi solar etj.)
- 1.12 **“Data e Operimeve Komerciale”** – Dita menjëherë pas datës në të cilën Gjeneratori është Komisionuar.
- 1.13 **“Komisionuar”** – Përfundimi i suksesshëm i Komisionimit të Gjeneratorit për operim sinkron me Operatorin e Sistemit në përputhje me Nenin 11 **Error! Reference source not found.** dhe certifikata e përfundimit të tillë të suksesshëm të Komisionimit nga Operatori i Sistemit.
- 1.14 **“Komisionim”** – Kryerja e Testeve të Komisionimit në Gjenerator.
- 1.15 **“Testet e Komisionimit”** – Testet që do të kryhen në përputhje me Nenin 11.3 - 11.5 **Error! Reference source not found.** dhe Shtojcën 5.
- 1.16 **“Kushtet e Kycjes”** – do të thotë tërësia e kushteve, të lëshuara nga Operatori i Sistemit për Gjeneratorin, për të kyçur stabilimentin në rrjetin relevant të Operatorit të Sistemit.
- 1.17 **“Stabilimentet e Kycjes”** – Do të thotë Stabilimentet e Kycjes së Operatorit të Sistemit dhe Prodhuesit të përshkruara veçanërisht në Shtojcën 3.
- 1.18 **“Pika e Kycjes”** – Pika ose pikat fizike ku Gjeneratori dhe Operatori i Sistemit do të kyçen siç është specifikuar në Shtojcën 3 në të cilën pikë Blerësi do të pranoj Neto Energjinë Elektrike të Liferuar.
- 1.19 **“Qendra Kontrolluese”** do të thotë qendra kontrolluese ose qendër tjetër e tillë siç mund të jetë e dizajnuar me shkrim nga Operatori i Sistemit kohë pas kohe që të jetë qendra kryesore kontrolluese për Gjeneratorin, siç përshkruhet më tej në Kodet Relevante.
- 1.20 **“Reduktim”** – Ngjarja e mos-pranimi të energjisë elektrike të prodhuar nga Centrali për shkak të problemeve në rrjet të përcaktuara në Nenin 3.4 të kësaj Marrëveshje.
- 1.21 **“Ditë”** – Do të thotë një periudhë njëzetë e katër (24) orë që fillon në 00.00 për çdo ditë kalendarike dhe përfundon në ora 00.00 në ditën pasuese kalendarike dhe data e Ditës do të jetë data e fillimit të saj, siç është e përcaktuar këtu. Ditë kalendarike do të thotë çdo ditë në një muaj, duke përfshirë edhe fundjavat dhe festat.
- 1.22 **“Kapaciteti i Deklaruar në Dispozicion”** – Do të thotë, për çdo orë të një Dite Operuese, kapaciteti total gjenerues i Gjeneratorit i shprehur në MW që Prodhuesi e ka deklaruar në dispozicion të Blerësit në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje.
- 1.23 **“Norma për Pagesë të Vonuar”** – EURIBOR plus dy përqind (2%) në vit, e bashkuar çdo gjashtë muaj, e llogaritur për numrin aktual të Ditëve për të cilat vlera përkatëse mbetet e papaguar bazuar në treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) Ditë të vitit
- 1.24 **“Mosmarrëveshje”** – Çdo mosmarrëveshje ose mospajtim ose dallim që del sipas, nga, ose në lidhje me këtë Marrëveshje, përfshirë çdo mosmarrëveshje ose dallim në lidhje

- me ekzistencën, ligjshmërinë, vlerfshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshje apo ndonjë dispozite në të, ose obligimet ose performancë e Palëve sipas ndonjë dispozite në këtë Marrëveshje.
- 1.25 **“Dispeçim”** – Ushtrimi i të drejtës nga Blerësi për të rritur, ulur apo ndërprerë gjenerimin e energjisë elektrike nga Gjeneratori duke dhënë Udhëzime të Dispeçimit në përputhje me këtë Marrëveshje, dhe “I Dispeçuar” do të interpretohet në përputhje me rrethanat. Dispeçimi në këtë Marrëveshje lidhet vetëm me ushtrimin në mes të Palëve të kësaj marrëveshje dhe jo me Operatorin e Sistemit.
- 1.26 **“Udhëzimet e Dispeçimit”** – Kuptim i atribuohet atij në Nenin 13. Udhëzimi për Dispeçim që përfshinë Udhëzimet e Dispeçimeve të njëpasnjëshme ose të rishikuara dhe Udhëzimet e Dispeçimit të rishikuara në bazë të informatave të dhëna nga Prodhuesi.
- 1.27 **“Data për pagesë dhe e Pagueshme”** – Kuptimi në Nenin 8.4(a).
- 1.28 **“Emergjencë”** – Një ngjarje ose rrethanë që ndikon në Operatorin e Sistemit e cila (i) përshkruhet si një ngjarje emergjente në Kodet Relevante, ose (ii) ndikon materialisht dhe negativisht (siç përcaktohet vetëm nga Operatori i Sistemit) në aftësinë e Blerësit për të mbajtur shërbime elektrike të sigurta, adekuate dhe të vazhdueshme për konsumatorët e vetë, duke pasur parasysh standardin e atëhershëm-tashëm të shërbimeve elektrike të ofruara për klientët e vetë, ose (iii) paraqet kërcënim fizik për personat ose pronën ose sigurinë, integritetin ose besueshmërinë e rrjetit të Operatorit të Sistemit, ose (iv) të cilën arsyeshem e pret Blerësi që të ketë efektet e përcaktuara në Nenin (ii) ose Nenin (iii).
- 1.29 **“Pagesa(t) e Energjisë”** – I referohet pagesës(ave) së Blerësit për Prodhuesin për Neto Energjinë Elektrike të Liferuar bazuar në Çmimin e Energjisë.
- 1.30 **“Çmimi i Energjisë”** – Çmimi i Neto Energjisë Elektrike të Liferuar dhe i shprehur në Euro për MWh siç është përcaktuar në Shtojcën 1 siç është përshtatur kohë pas kohe në përputhje me dispozitat e saj.
- 1.31 **“Data Efektive”** – Do të thotë data në të cilën kërkesat e parapara në Nenin 2.1 të kësaj Marrëveshje janë përfunduar.
- 1.32 **“Prodhimi i Energjisë Elektrike”** do të thotë, në çdo periudhë gjatë Afatit, i tërë prodhimi i energjisë elektrike (i shprehur në kilovat-orë (kWh)) i gjeneruar nga Gjeneratori dhe dërguar në Pikën e Liferimit në atë periudhë (dhe, në lidhje me çdo periudhë më të shkurtër, do të thotë prodhimi i energjisë elektrike i liferuar në atë periudhë) siç matet nga Matësi;
- 1.33 **“EURIBOR”** – Federata Bankare Evropiane për Rregullimin e Normës së Interesit për depozitat në Euro për një periudhë të barabartë me tre (3) muaj që shfaqet në faqen e duhur të shërbimit të Reuters në ose rreth orës 11:00 (CET) në Bruksel në Ditën e Fundit Bankarë në Bruksel që është në dispozicion, ose në rast se shërbimi Reuters, ose çdo pasues i saj, nuk e jep më një informatë të tillë, një shërbim tjetër i tillë i dakorduar nga Palët që jep Rregullimin e Normës së Interesit nga Federata Bankare Evropiane për depozitat në Euro.
- 1.34 **“ZRRE”** – Do të thotë Zyra e Rregullatorit për Energji e themeluar në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.05/L –084).
- 1.35 **“Njoftimi për Kontestim të Faturës”** – Kuptimi i atribuohet atij në Nenin 9.1
- 1.36 **“Tarifa Nxitëse”** – Kuptimi është i paraqitur në Shtojcën 1.

- 1.37 **“Forca Madhore”** – Kuptimi është i paraqitur në Nenin 34.
- 1.38 **“Gjenerator”** – Stabiliment i gjenerimit të energjisë elektrike i përbërë nga [●] gjeneratorët me turbinë (secili i referuar si **“Njësi Gjeneruese”**) që ndodhen në Vendndodhje dhe Stabilimentet e Kyçjes së Prodhuesit (por duke përjashtuar Stabilimentet e Kyçjes së Operatorit të Sistemit) që ka një kapacitet të vlerësuar nominal prej përafërsisht [●] MW (bruto)
- 1.39 **“Rrjet”** një kombinim i linjave të energjisë elektrike dhe pajisjeve elektrike të tensionit të lartë, mesëm dhe ulët për t’i shërbyer shpërndarjes dhe transmisionit të energjisë elektrike;
- 1.40 **“Legjislacioni i Kosovës”** – Ligjet e Kosovës, të gjitha urdhëresat, rregullat, rregulloret, urdhëresat ekzekutive, urdhëresat ligjore rregullative, vendimet gjyqësore, njoftimet, dhe direktiva tjera të ngjashme të lëshuara nga ndonjë autoritet publik, njëjtë siç mund të ndryshohet secili prej tyre kohë pas kohe.
- 1.41 **“Ngjarje Politike në Kosovë”** – Kuptimi i atribuohet atij në Nenin 34.1(a).
- 1.42 **“NFMPK”** – Kuptimi i atribuohet atij në Nenin 34.1(a)
- 1.43 **“Përfundimi i Pëlqimit”** – Çdo Pëlqim i Prodhuesit (a) nuk mbetet në fuqi dhe në efekt të plotë dhe nuk është ripërtëritë ose zëvendësuar brenda periudhës kohore të përcaktuar me Legjislacionin në fuqi në Kosovë ose (b) nuk është lëshuar me rastin e aplikimit, nuk është bërë si duhet dhe me kohë dhe nuk është ndjekur me kujdes ose (c) nuk i është nënshtruar, pas ripërtëritjes ose ndryshe, ndonjë kushti që materialisht dhe negativisht ndikon në aftësinë e Palës për të kryer obligimet sipas Marrëveshjes, në secilin prej rasteve të mësipërme, pavarësisht përputhmërisë së Palës së tillë me procedurat dhe kërkesat e aplikueshme, ashtu siç aplikohen në një “mënyrë jo-diskriminuese.”
- 1.44 **“Ligji për Energjinë Elektrike”** – Do të thotë Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085).
- 1.45 **“Humbje”** – Çdo humbje, dëmtim, përgjegjësi, pagesë dhe obligim (duke përjashtuar çdo humbje indirekte ose pasuese, dëmtim, përgjegjësi, pagesë ose obligim), dhe të gjitha shpenzimet (duke përfshirë, pa kufizim, tarifat e arsyeshme ligjore).
- 1.46 **“Ndërprerje për Mirëmbajtje”** – Do të thotë çdo ndërprerje ose reduktim i kapacitetit gjenerues të energjisë elektrike të Gjeneratorit e cila: (i) nuk është Ndërprerje e Planifikuar; (ii) është koordinuar me Blerësin në përputhje me Nenin 146 këtu; dhe (iii) është për qëllim të kryerjes së punëve në komponentë specifike të Gjeneratorit, punë e cila mund të shtyhet për së paku 72 orë, por për mendimin e Prodhuesit nuk duhet të shtyhet deri në Ndërprerjen e ardhshme të Planifikuar;
- 1.47 **“Rregullat e Tregut”** – Do të thotë Rregullat e Tregut me shumicë, të përgatitura në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe çdo ndryshim ose variacion të miratuar aty.
- 1.48 **“Kodi i Matjes”** – Do të thotë një tërësi rregullash dhe procedurash që rregullojnë matjen që përdoret në rrjetin e shpërndarjes [nëse është i lidhur në nivel të Transmisionit, duhet të lexohet: që përdoren në transmision] në Kosovë, dhe çdo ndryshim ose variacion në të.
- 1.49 **“Pala Kontestuese e Matjes”** ka kuptimin e dhënë në Nenin 6.5.

- 1.50 **“Sistemi i Matjes”** – Të gjithë matësit dhe pajisjet matëse (duke përfshirë çdo njësi të largët të terminalit dhe një regjistruar elektronik të të dhënave dhe sistemin e telemetrisë) që do të instalohen në Pikën e Këqjes, dhe më pas në pronësi dhe të mirëmbajtura nga Operatori i Sistemit dhe të përdorura për të matur Neto Energjinë Elektrike të Liferuar nga Gjeneratori.
- 1.51 **“Muaj”** – Një muaj kalendarik sipas kalendarit Gregorian që fillon në orën 12:00 në mesnatë në Ditën e fundit të muajit paraardhës dhe përfundon në orën 12:00 në mesnatë në Ditën e fundit të atij muaji.
- 1.52 **“Energjia Mujore”** – Për çdo Muaj, shuma e Neto Energjisë Elektrike të Liferuar.
- 1.53 **“Pagesa Mujore e Energjisë”** - Kuptimi i atribuohet atij në Nenin 8.2.
- 1.54 **“Neto Energjia Elektrike e Liferuar”** – Neto energjia elektrike e shprehur në kWh e cila gjenerohet nga Gjeneratori dhe liferohet në Pikën Këqese, ashtu siç është matur nga Sistemi i Matjes.
- 1.55 **“Njoftimi për Qëllimin e Shkëputjes”** – Një njoftim i dhënë nga Prodhuesi ose Blerësi, siç mund të jetë rasti, për qëllimin e tij për të shkëputur këtë Marrëveshje në pajtim me Nenin 20 për shkak të mosplotësimit të zotimeve nga Pala tjetër.
- 1.56 **“Ngjarje që nuk ka të bëjë me Projektin”** – Secila nga ngjarjet apo rrethanat e mëposhtme:
- (a) kufizimet mbi Operatorin e Sistemit,
 - (b) ndryshimet në Frekuencën e Operatorit të Sistemit të cilat janë jashtë Kufizimeve Teknike,
 - (c) tensioni i Operatorit të Sistemit i cili është jashtë Kufizimeve Teknike,
 - (d) një Emergjencë, ose
 - (e) Udhëzim i Dispeçimit,
- në secilin rast (i) të qenit shkaku i afërt dhe i drejtpërdrejtë i ndërprerjes ose reduktimit të gjenerimit të Gjeneratorit, dhe (ii) jo i shkaktuar nga kushtet e operimit në Gjenerator ose një defekti ose dështimi të ndonjë pajisje ose pajisje e sigurisë të përfshirë në Gjenerator.
- 1.57 **“Kontraktori O&M”** – Çdo Kontraktorë i operimit dhe mirëmbajtjes, dhe çdo pasues i tij, i caktuar nga Prodhuesi për operim dhe mirëmbajtje të Gjeneratorit dhe që nuk është kundërshtuar nga Blerësi.
- 1.58 **“Muaji i Pikut”** – Do të thotë ndonjë nga Muajt në vazhdim: Tetori, Nëntori, Dhjetori, Janari, Shkurti dhe Marsi.
- 1.59 **“Ditë Operuese”** – Do të thotë çdo periudhë prej 24 orësh rresht duke filluar në ora 00.00, gjatë afatit të Marrëveshjes.
- 1.60 **“Prodhues”** – [●] një kompani e inkuorporuar sipas ligjeve të [●] me numrin e regjistruar [●] zyra e regjistruar e të cilit është në [●] dhe pasuesit dhe të caktuarit e tij të lejuar.
- 1.61 **“Stabilimentet Këqese të Prodhuesit”** – Stabilimentet dhe pajisjet e dizajnuara, ndërtruara dhe instaluar nga ose në emër të Prodhuesit në anën e Pikës Këqese të Prodhuesit të cilat janë të përshkruara në Shtojcën 3, duke përfshirë çdo Sistem telemetrimi, linja transmisioni dhe pajisje përcjellëse, transformatorë dhe pajisje përcjellëse, pajisje rele dhe shëndrues, pajisje telekomunikimi, pajisje telemetrimi dhe mbrojtëse dhe pajisje të sigurisë.

- 1.62 **“Programi për Testime”** – Informatat e detajuara të dhëna nga Gjeneratori për Operatorin e Sistemit për testimin e stabilimentit, që ndër tjera përfshinë përshkrimin e stabilimentit dhe pajisjeve, kohën e propozuar për testim, orarin e testeve dhe personelin e përfshirë për testim në përputhje me Nenin 10, Shtojca 5, dhe Kodet Relevante.
- 1.63 **“Projekt”** – Stabilimenti i gjenerimit të energjisë i përbërë nga Gjeneratori i vendosur në Vendndodhje dhe Stabilimentet Kyçëse të Prodhuesit (por duke përjashtuar Stabilimentet Kyçëse të Operatorit të Sistemit) që ka një kapacitet të vlerësuar nominal prej përafërsisht [●] MW (bruto) i dizajnuar, projektuar, ndërtuar, Komisionuar, në pronë dhe operuar dhe mirëmbajtur nga Prodhuesi gjatë Afatit, çoftë i përfunduar ose në ndonjë fazë të ndërtimit të tij, duke përfshirë pa kufizime ose në lidhje me nivelin e zhvillimit, inxhinieringut dhe dokumenteve të dizajnit, të gjitha pajisjet e prodhimit të energjisë dhe pajisjet ndihmëse, [rezervuar], porta e ujit, kanali hyrës, [kanali i shkarkimit], komunikimi i të dhënave dhe pajisjet dhe sistemet e regjistrimit, pjesët rezervë të deponuara në Vendndodhje, të gjitha Stabilimentet Kyçëse të Prodhuesit dhe të gjitha pajisjet tjera ose stabilimentet e nevojshme për liferimin e energjisë elektrike tek Blerësi në Pikën Kyçëse, i cili Gjenerator është i përshkruar në Shtojcën 2.
- 1.64 **“Praktikat e Matura të Shfrytëzimit”** – Ato praktika, metoda dhe procedura konform kërkesave ligjore dhe të sigurisë të cilat arrihen duke ushtruar atë nivel të aftësive, kujdesit, maturisë dhe largpamësisë e cila arsyeshëm dhe zakonshëm do të pritej nga gjeneratori i energjisë elektrike i shkathët dhe me përvojë i angazhuar në një ndërmarrje të llojit të njëjtë apo të ngjashëm ose aktivitet nën rrethana dhe kushte të njëjta apo të ngjashme me ato që i përkasin Kosovës dhe që plotësojnë standardet e shëndetit, sigurisë dhe ambientit të kompanive me reputacion ndërkombëtar të gjenerimit të energjisë elektrike. Praktikat e Matura të Shfrytëzimit nuk janë të kufizuara në praktikat, metodat dhe veprimet optimale në përjashtim të të gjitha tjerave, por më saktë, kur nuk është e shprehur saktësisht në Kode Relevante, janë në spektrin e praktikave të mundshme, metodave dhe veprimeve të cilat mund të kenë qenë të pritshme për të përmbushur rezultatin e dëshiruar me një kosto të arsyeshme në përputhje me besueshmërinë dhe sigurinë e aplikueshme në lidhje me projektet hidroenergjetike (përfshirë integrimin e tyre të sigurt dhe të besueshëm në sistemet e dobëta të rrjetit).
- 1.65 **“Blerësi”** –entiteti ashtu siç është përcaktuar në preambulën e kësaj Marrëveshje dhe pasuesit dhe të caktuarit e tij.
- 1.66 **“Pëlqimet e Prodhuesit”** – Të gjitha miratimet, pëlqimet, autorizimet, njoftimet, lëshimet, pranimet, licencat, lejet, vendimet ose artikuj të ngjashëm të cilat janë lëshuar nga Autoriteti Relevant dhe të cilat Prodhuesi ose ndonjëri prej kontraktorëve të tij kërkohet që ti marrë nga ndonjë Autoritet Relevant (përveç Blerësit) dhe më pas të mbajë përmbushjen e obligimeve të veta sipas kësaj Marrëveshje, duke përfshirë anëtarësimin e Njësive Gjeneruese në Skemën Mbështetëse ose në bazë të Kornizës së Rregulluar.
- 1.67 **“Person”** – Çdo person, firmë, kompani, korporatë, shoqëri, qeveri, shtet ose agjenci e shtetit (duke përfshirë çdo Entitet të Sektorit Publik) ose ndonjë shoqatë ose partneritet (çoftë që ka apo jo personalitet të ndarë ligjor) të dy ose më shumë prej të lartpërmendurave.
- 1.68 **“Ngjarja e Mospërmbushjes së Blerësit”** – Kuptimi i atribuohet atij në Nenin 19.

- 1.69 “**Ngjarja e Mospërmbushjes së Prodhuesit**” – Kuptimi i atribuohet atij në Nenin 18.
- 1.70 “**Entitet i Sektorit Publik**” – (a) Qeveria e Kosovës, ose ndonjë autoritet qeveritar lokal me juridiksion mbi Prodhuesin, Blerësin, ose ndonjë pjesë të tyre, ose (b) çdo departament, autoritet, instrumentalitet, agjenci, ose trupe gjyqësore e Qeverisë së Kosovës ose ndonjë autoritet i tillë i qeverisë lokale, (c) gjykatat dhe tribunalet në Kosovës, dhe (d) çdo komision apo agjenci e pavarur rregullative ose trupë që ka juridiksion mbi Prodhuesin, Gjeneratorit, ose ndonjë pjesë të tyre.
- 1.71 “**Autoritet Relevant**” – Departamenti, autoriteti, instrumentaliteti, agjencia ose ndonjë entitet tjetër relevant nga i cili duhet të merret Pëlqimi nga Prodhuesit dhe çdo autoritet, trupë ose Person tjetër që ka juridiksion sipas Legjislacionit në Kosovë në lidhje me Gjeneratorin, Blerësin dhe këtë Marrëveshje, siç mund të jetë rasti, i cili duhet të përfshijë ZRRE-në.
- 1.72 “**Korniza e Rregulluar**” – do të thotë korniza e rregulluar e zbatueshme për Stabilimentet Gjeneruese BRE që nuk janë të pranuar në Skemën Mbështetëse të cilat nuk dëshirojnë të operojnë në tregun e hapur.
- 1.73 “**Kodet Relevante**” – Do të thotë një tërësi e rregullave dhe standardeve teknike, të miratuara nga ZRRE, që rregullojnë përdorimin e rrjetit të shpërndarjes dhe transmisionit në Kosovë, dhe çdo ndryshim ose variacion të tij.
- 1.74 “**Rregulla për Skemën Mbështetëse**” do të thotë një tërësi dispozitash për të mbështetur energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë në Kosovë. Të përcaktuara në Rregullën për Skemën Mbështetëse – ashtu siç është miratuar nga ZRRE-ja.
- 1.75 “**Vendndodhje**” – Toka, rrugët e ujit, rrugët, pusët, të drejtat e rrugës, dhe interesa tjera në tokë dhe çdo e drejtë, leje dhe licencë e marrë nga Prodhuesi për qëllime të Projektit në, përmes, mbi ose nën tokë në lokacionin e paraqitur në Shtojcën 5, në të cilën i tërë ose një pjesë e Gjeneratorit është ndërtuar ose në bazë të të cilit është marrë qajsa ose e cila është arsyeshëm e nevojshme ose e duhur për operim dhe mirëmbajtje të Gjeneratorit.
- 1.76 “**Deklarata e Disponueshmërisë**” – Përcaktimi i shkruar që do të lëshohet nga Gjeneratori për Operatorin e Sistemit sipas Nenit 11.1 ku thuhet, në lidhje me Gjeneratorin, se Gjeneratori ka dorëzuar Programin e nevojshëm për Testime dhe se Gjeneratori është i gatshëm dhe i aftë për sinkronizim me Operatorin e Sistemit dhe është në dispozicion për prodhim dhe shpërndarje të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar, dhe se Gjeneratori është në gjendje që me sukses të përfundoj Testet Komisionuese.
- 1.77 “**Operatori i Sistemit**” – nënkupton kompaninë që zotëron dhe operon me operatorin e sistemit të shpërndarjes, të licencuar nga ZRRE-ja, ose operatorin e sistemit të transmisionit, të licencuar nga ZRRE-ja, në të cilin një rrjet i përdoruesve të sistemit janë të kyçur, varësisht nga Pika Kyçëse e Gjeneratorit.
- 1.78 “**Stabilimentet Kyçëse të Operatorit të Sistemit**” – Stabilimentet dhe pajisjet e dizajnuara, ndërtuara ose instaluar nga ose në emër të Operatorit të Sistemit në anën e Operatorit të Sistemit të Pikës Kyçëse që janë të përshkruara në Shtojcën 3.
- 1.79 “**Ndërprerja e Planifikuar**” – Një ndërprerje e planifikuar e aftësisë gjeneruese të Gjeneratorit apo ndonjë pjese materiale që është planifikuar nga Prodhuesi në konsultim me Blerësin në përputhje me Nenin 14 për inspektim, testim, mirëmbajtje parandalim,

- mirëmbajtje korigjuese, riparim, ndërrim ose përmirësim i Gjeneratorit apo të ndonjë pjese materiale.
- 1.80 **“Tatim”** ose **“Tatime”** – Çdo tatim, ngarkesë, taksë, tarifë, detyrim, bazë për vlerësimin e tatimeve (duke përfshirë normat e ose periudhat e zhvlerësimit të aseteve për qëllime të vlerësimeve tatimore), koncesione fiskale ose lejim i imponuar nga ose i pagueshëm për Qeverinë e Kosovës, ose një agjent, duke përfshirë çdo tatim mbi vlerën e shtuar, taksën ujore ose mjedisore ose të energjisë, detyrimet tatimore të importit dhe doganore, tatimi në burim, akciza, tatimi në monedhën e huaj apo të transaksioneve të këmbimit valutor ose tatim në pronë.
- 1.81 **“Kufizimet Teknike”** – Kufijtë dhe kufizimet në Shtojcën 5 në lidhje me operimin, mirëmbajtjen dhe Dispeçimin e Gjeneratorit.
- 1.82 **“Energjia Testuese”**- Do të thotë Neto Energjia Elektrike e Liferuar e gjeneruar dhe liferuar kohë pas kohe gjatë periudhës pas Datës së Disponueshmërisë, por para Datës së Operimit Komercial.
- 1.83 **“Data e Shkëputjes”** – Kuptimi i atribuohet atij në Nenin 21 dhe Nenin 22.
- 1.84 **“Afati”** – Nënkupton kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshje ashtu siç është përcaktuar në Nenin 2.2 të kësaj Marrëveshje.
- 1.85 **“Njoftimi për Shkëputje”** – Kuptimi i atribuohet atij në Nenin 21.
- 1.86 **“Javë”** – Çdo periudhë prej shtatë (7) Ditëve të njëpasnjëshme duke filluar në ora 12:00 ne mesnatën që bie në mes të një të Shtune dhe të Diele.
- 1.87 Në këtë Marrëveshje:
- (a) referencat në gjininë mashkullore do të përfshijnë edhe gjininë femërore dhe referencat në njëjës do të përfshijnë edhe shumësin dhe anasjelltas;
 - (b) titujt janë vetëm për lehtësi dhe duhet të injorohen në interpretimin e kësaj Marrëveshje;
 - (c) përveç nëse thuhet ndryshe këtu, kurdo që kërkohet ndonjë pëlqim ose miratim nga njëra Palë për Palën tjetër, pëlqimi ose miratimi i tillë nuk do të refuzohet ose vonohet pa arsye;
 - (d) fjalët “përfshinë”, “duke përfshirë” dhe “në veçanti” do të interpretohen vetëm si ilustrim apo theksim dhe nuk do të interpretohen si, dhe nuk do të kenë efekt si, kufizim i përgjithësimin të ndonjë fjale të mësipërme;
 - (e) referenca në Palë dhe referenca në një palë në këtë Marrëveshje, përfshirë të caktuarit ose të transferuarit e Palës të lejuar në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje dhe pasardhësve të tij në titull;
 - (f) në kryerjen e obligimeve dhe detyrave sipas kësaj Marrëveshje, secila Palë do të ketë një obligim të nënkuptuar në besim të mirë;
 - (g) përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, referencat në një Nen të veçantë, paragraf ose Shtojcë do të jenë referencë në atë Nen, paragraf ose Shtojcë në këtë Marrëveshje;
 - (h) referenca në një marrëveshje ose dokument do të jetë referencë në të aq sa është e ndryshuar, plotësuar ose zëvendësimit kohë pas kohe në përputhje me, dhe subjekt i çdo kërkese të kësaj Marrëveshje dhe (subjekt i saj) do të përfshijë referencën në çdo dokument i cili ndryshon, është plotësues,

zëvendëson, i lidhur, bërë apo i dhënë sipas ose në përputhje me çdo kusht të saj;

- (i) referencat në një dispozitë ligjore (përshirë edhe çdo legjislacion sekondar) do të përfshijë kohë pas kohe dispozita të tillë ashtu siç është modifikuar ose rimiruar ose konsolidimi është i aplikueshëm ose është në gjendje që të aplikohet në ndonjë transaksion të lidhur në bazë të kësaj Marrëveshje;
- (j) kur ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshje parashikon se ndonjë fjalë apo shprehje do të ketë kuptimin e dhënë në të ose të ketë të njëjtin kuptim të cilin e ka në marrëveshje ose dokumente tjera; kuptimi i tillë do të mbetet i plotfuqishëm dhe në fuqi dhe fjala ose shprehja do të vazhdojë të ketë kuptimin e tillë pavarësisht se marrëveshja e tillë relevante ose dokumenti skadon ose shkëputet për ndonjë arsye;
- (k) çdo referencë në valutë, i referohet monedhës zyrtare në Kosovë;
- (l) të gjitha njësitë e energjisë, masës, peshës, kohës, gjatësisë, vëllimit, shtypjes, temperaturës dhe pronave tjera fizike janë të demonstruara në Systemë International des Unités (SI) (edicioni i 7, 1998) në përputhje me definicionet, njësitë dhe akronimet e specifikuara nga Bureau International des Poids et Mesures; dhe
- (m) Në këtë Marrëveshje, shkurtesat e mëposhtme do të kenë kuptimet si më poshtë:
 - °C do të thotë Celsius;
 - kV do të thotë kilovolt ose 1,000 Volt;
 - kW do të thotë kilovat ose 1,000 Vat;
 - kWh do të thotë kilovat orë;
 - m/s do të thotë metra për sekondë;
 - MW do të thotë megavat ose 1,000,000 Vat;
 - Mvar do të thotë megavar ose 1,000,000 var;
 - MWh do të thotë megavat orë ose 1,000 kWh; dhe
 - GWh do të thotë gigavat orë ose 1,000,000 kWh.

2. FILLIMI DHE AFATI

2.1 Dispozitat e kësaj Marrëveshje do të jenë në fuqi nga data në të cilën secila nga kushtet e mëposhtme të jenë përmbushur ("**Data Efektive**").

- (a) Marrëveshja është nënshkruar nga të dyja Palët,
- (b) Operatorët e Sistemit janë njoftuar, në përputhje me Rregullën për Skemën Mbështetëse.

- 2.2 Që nga Data e Operimeve Komerciale, kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë për një periudhë prej [10 (dhjetë) vjet] ose [12 (dymbëdhjetë) vjet]¹, ose deri në Datën e Shkëputjes.
- 2.3 Gjatë afatit të kësaj Marrëveshje, secila Palë do të veproj në përputhje me Legjislacionin Kosovar dhe të gjitha marrëveshjet dhe rregullat tjera që kërkohet të ndjek ose të pajtohet me to sipas Legjislacionit Kosovar, ose çdo licencë, si dhe çdo ligj dhe rregullore në Republikën e Kosovës.
- 2.4 Gjatë afatit të kësaj Marrëveshje, çdo çështje që nuk rregullohet shprehimisht me këtë Marrëveshje do të rregullohet nga Legjislacioni i Kosovës i cili qeveris me tregun e energjisë elektrike në Republikën e Kosovës.

3. BLERJA DHE SHITJA E ENERGISË ELEKTRIKE

- 3.1 Në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshje, Prodhuesi do të shesë dhe liferoj dhe Blerësi do të blejë dhe pranoj të tërë Neto Energjinë Elektrike të Liferuar të gjeneruar nga Gjeneratori dhe të liferuar në Pikën Kyçëse nga Prodhuesi në rrethanën e përshkuara në Shtojcën 3. Neto Energjia Elektrike e Liferuar do të liferohet tek Blerësi në Pikën Kyçëse në formën, duke përfshirë tensionin dhe ndryshimin e frekuencës që është në përputhje me Kodet Relevante, Marrëveshjen e Kyçjes dhe në përputhje me Praktikën e Matura të Shfrytëzimit.
- 3.2 Për të shmangur dyshimin, në asnjë rast, Blerësi nuk ka obligim të paguaj për Neto Energjinë Elektrike të Liferuar të prodhuar nga Gjeneratori para Datës së Disponueshmërisë.
- 3.3 Pavarësisht nga dispozitat tjera të kësaj Marrëveshje, Blerësi, pas njoftimit nga Operatori i Sistemit, nuk do të jetë i obliguar të pranojë energji elektrike nga Gjeneratori nëse ndonjëra nga ngjarjet e përshkuara më poshtë ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë:
- (a) shfaqet një ngjarje Emergjente, në të cilin rast Operatori i Sistemit nuk është në gjendje të pranojë Neto Energjinë Elektrike të Liferuar nga Gjeneratori;
 - (b) Operatori i Sistemit në diskrecionin e vetë, dhe pas dhënies së njoftimit paraprak për Prodhuesin, ndërprejë pranimin e energjisë elektrike nga Gjeneratori për të kryer mirëmbajtjen e nevojshme në stabilimentet e rrjetit që janë afër Stabilimenteve Kyçëse të cilat nuk mund të presin deri në Ndërprerjen e ardhshme të Planifikuar; ose
 - (c) sipas mendimit të arsyeshëm të Operatorit të Sistemit, Gjeneratori prodhon energji elektrike të karakterit që nuk përputhet me atë që është e përshkruar në Kodet Relevante, ose që mund të ndikoj negativisht në siguri, besueshmëri ose sigurinë e pajisjeve, stabilimenteve, personelit ose sistemit të Operatorit të

¹ Dhjetë vite për Burim Hidro dhe Biomasa, dhe dymbëdhjetë vite për Burime Fotovoltaike dhe të Erës

Sistemit, ose për konsumatorët e Blerësit. Në një rast të tillë, Operatori i Sistemit, sipas Kodeve Relevante, do të njoftoj Prodhuesin rreth kësaj gjendje dhe i lejon Prodhuesit kohë të arsyeshme për të korrigjuar atë. Nëse Prodhuesi dështon të korrigjoj gjendjen brenda kohës së arsyeshme, Operatori i Sistemit mund të ndalë fizikisht rrjedhën e energjisë elektrike nga Gjeneratori deri sa gjendja të jetë korrigjuar me kusht që Gjeneratori është duke operuar në përputhje me standardet operuese të përcaktuara në Kodet Relevante.

- 3.4 Nëse, gjatë afatit të marrëveshjes, Prodhuesi nuk është në gjendje të liferoj energji elektrike në Rrjet për shkak të ndonjërit nga ngjarjet e sipërpërmendura në Nenin 3.3, Prodhuesi do të kompensohet duke zgjatur afatin e kësaj marrëveshje në përputhje me orët e Redukuara.
- 3.5 Prodhuesi është i obliguar që të mbajë regjistra të detajuar rreth numrit të orëve të reduktimeve për çdo vit, duke përfshirë të gjitha dokumentet mbështetëse të pranuar nga Operatorit i Sistemit, dhe është i obliguar të paraqes të dhënat tek Blerësi dhe ZRRE-ja në fund të secilit Vit të Marrëveshjes. Të gjitha komunikimet e bëra në mes të Prodhuesit dhe Operatorit të Sistemit në lidhje me Nenin 3.3 do të regjistrohen nga Prodhuesi dhe një kopje ose transkriptimi i regjistrimeve të tilla do ti jepet Blerësit, nëse ai i kërkon ato.
- 3.6 Prodhuesi nuk duhet, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Blerësit, të shesë ose liferoj prodhimin e energjisë elektrike të Gjeneratorit tek ndonjë person tjetër përveç Blerësit gjatë Afatit të kësaj Marrëveshje.
- 3.7 Prodhuesi nuk do të ndërmarrë asnjë veprim i cili do të pengoj, keqësoj ose zvogëloj aftësinë e Prodhuesit për të gjeneruar, shitur dhe liferuar Neto Energjinë Elektrike të Liferuar në përputhje me këtë Marrëveshje.
- 3.8 Të gjitha veprimet që kërkohen ose ndërmarrën sipas kësaj Marrëveshje nga cilado Palë në çdo kohë duhet të jenë në përputhje me Kodet Relevante dhe Praktikën e Matura të Shfrytëzimit.

4. PAGESA E ENERGJISË

- 4.1 Për secilën periudhë faturuese që fillon në dhe pas Datës së Disponueshmërisë dhe për pjesën e mbetur të Afatit të kësaj Marrëveshje, Blerësi do të paguajë Prodhuesin për Neto Energjinë Elektrike të Liferuar nga Gjeneratori dhe të pranuar nga Blerësi dhe të matur në përputhje me Nenin **Error! Reference source not found.**, në Pikën Kyçëse, gjatë një periudhe të tillë faturuese. PAGESA për Neto Energjinë Elektrike të Liferuar për secilën periudhë faturuese do të llogaritet në përputhje me Çmimin e Energjisë të përshkruar në Shtojcën 1, me përjashtim të Energjisë Testuese, e cila do të llogaritet bazuar në Nenin 4.2.
- 4.2 Palët pajtohen se Neto Energjia Elektrike e Liferuar në Ditën pas Ditës së Disponueshmërisë por para Datës së Operimeve Komerciale do të trajtohet si Energji Testuese. Çmimi për Energji Testuese do të jetë i barabartë me 60% të Çmimit të Energjisë.

- 4.3 Blerësi pajtohet që të siguroj furnizim me energji elektrike për Gjeneratorin me tarifë mbizotëruese relevante të Blerësit, varësisht nga nevojat për vetë konsum të Prodhuesit, dhe konsumi në fjalë do të paguhet nga Prodhuesi dhe do të matet ndaras nga Neto Energjia Elektrike e Liferuar.
- 4.4 Çdo miratim, ndryshim, anulim, ose ri-interpretim i Çmimit të Energjisë gjatë Afatit të Marrëveshjes, i përshkruar në Shtojcën 1, nuk do të ketë ndikim në të hyrat e Prodhuesit për Neto Energjinë Elektrike të Liferuar.

5. KYÇJA

- 5.1 Prodhuesi do të jetë përgjegjës për financimin, projektimin, blerjen, ndërtimin, kompletimin, testimin, dhe komisionimin e Stabilimenteve Kyçëse të Prodhuesit me të gjithë aftësinë dhe kujdesin e duhur dhe në të gjitha aspektet materiale në përputhje me:
- (a) këtë Marrëveshje, veçanërisht Shtojcën 3;
 - (b) Kodet Relevante,
 - (c) Legjislacionin e Kosovës, sa i përket Vendndodhjes;
 - (d) Kushtet e Kyçjes;
 - (e) Praktikrat e Matura të Shfrytëzimit;
- 5.2 Prodhuesi do të pajis me dhe instalojë reletë mbrojtëse, transformatorët ngritës dhe pajisjet tjera mbrojtëse që Prodhuesi mund ti gjykoj si të nevojshme në përputhje me Kodet Relevante dhe Praktikrat e Matura të Shfrytëzimit, duke u siguruar sido që të jetë se të gjitha pajisjet e tilla mbrojtëse do të jenë në përputhje me kërkesat e Operatorit të Sistemit. Përveç nëse parashikohet ndryshe në Kodet Relevante, Prodhuesi do të jetë përgjegjës për mbrojtjen e stabilimenteve të veta nga dëmet e mundshme të shkaktuara nga çrregullimet në Operatorin e Sistemit ose probleme tjera që dalin nga operimi i stabilimenteve të Operatorit të Sistemit.
- 5.3 E drejta, dhe rreziku i humbjes në energjinë elektrike të gjeneruar nga Gjeneratori dhe të transmetuar tek Blerësi në përputhje me këtë Marrëveshje do të kalojë tek Blerësi në Pikën Kyçëse.

6. MATJA

- 6.1 Palët pranojnë se për qëllime të përcaktimit të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar, Sistemi i Matjes kërkohet para se të liferohet çdo Neto Energji Elektrike e Liferuar në Pikën Kyçëse për shitjen sipas kësaj Marrëveshje. Prodhuesi ka të drejtë, por jo obligim, që me kosto të veten të instalojë ndonjë matës rezervë. Sistemi i Matjes duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Kodit të Matjes.
- 6.2 Neto Energjia Elektrike e Liferuar do të matet nga Sistemi i Matjes i vendosur në Pikën Kyçëse. Sistemi i Matjes duhet të blihet dhe instalohet në përputhje dhe në pajtim me kërkesat e Kodit të Matjes. Pas instalimit të Sistemit të Matjes, Operatori i Sistemit i ka të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat në Sistemin e Matjes. Në rast se Sistemi i Matjes

është i instaluar në ndonjë lokacion tjetër e jo në Pikën Kyçëse, sasia e Energjisë do të përshtatet për të lejuar humbjet teknike në mes të lokacionit të Sistemit të Matjes dhe Pikës Kyçëse. Në raste të tilla, humbjet teknike duhet të llogariten bazuar në Praktikën e Matura të Shfrytëzimit.

- 6.3 Sistemi i Matjes do të jetë i mbyllur dhe mbyllja do të thyhet vetëm ashtu siç parashihet në Kodin e Matjes.
- 6.4 Operatori i Sistemit, sipas Kodit të Matjes, është përgjegjës për inspektimin dhe testimin e të gjitha Sistemeve Matëse kur të instalohen dhe periodikisht pas instalimit. Prodhuesi duhet të pranoj një njoftim të arsyeshëm paraprak rreth inspektimeve dhe testeve të tilla dhe do të lejohet një përfaqësues i Prodhuesit që të jetë dëshmitar dhe të verifikoj inspektimet dhe testimet e tilla, si dhe çdo përshtatje të bërë si rezultat i saj; me kusht që, nëse përfaqësuesi i tillë nuk është prezent në kohën e caktuar, inspektimi, testi ose përshtatja mund të vazhdojnë siç janë planifikuar, në përputhje me Kodin e Matjes.
- 6.5 Nëse në çdo kohë, cilado Palë beson që Neto Energjia Elektrike e Liferuar nuk ka qenë e regjistruar si duhet (“Pala Kontestuese e Matjes”), Pala Kontestuese e Matjes duhet të dorëzojë kërkesën tek Operatori i Sistemit për verifikim të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar dhe/ose testim të Sistemit të Matjes.
- 6.6 Pala Kontestuese e Matjes duhet që menjëherë të njoftoj Palën tjetër për kërkesën e parashtruar te Operatori i Sistemit.
- 6.7 Nëse testi i Sistemit të Matjes tregon se saktësia e tij është brenda niveleve të saktësisë të përcaktuara në Kodin e Matjes, kosto e testimit duhet të paguhet nga Pala Kontestuese e Matjes.
- 6.8 Nëse shihet se Sistemi i Matjes është me defekt ose i pasaktë, ai do të rregullohet, riparohet, ndërrohet dhe/ose ri-kalibrohet nga Operatori i Sistemit. Nëse Sistemi i Matjes nuk regjistron, ose nëse matjet e bëra nga një pajisje e tillë shihet pas testimit se janë të pasakta me më shumë se +/- 1% nga pika kalibruese projektuese, duhet të rregullohet për të korrigjuar të gjitha matjet e bëra nga një pajisje e tillë matëse për qëllime faturimi si për shumën e pasaktësisë po ashtu edhe për periudhën e pasaktësisë. Nëse një periudhë e tillë është e papërcaktueshme, regjistrimet e kaluara do të korrigjohen mbrapa për gjysmën e kohës së kaluar që nga data e testit të fundit. Nëse shumën e pasaktësisë nuk mund të përcaktohet, ose nëse Sistemi i Matjes është jashtë përdorimit si rezultat i mirëmbajtjes, riparimeve ose testeve për ndonjë periudhë, Neto Energjia Elektrike e Liferuar gjatë një periudhe të tillë do të përcaktohet në bazë të të dhënave më të mira që janë në dispozicion, duke përdorur renditjen e mëposhtme të përparësisë:
 - (a) duke korrigjuar gabimin nëse përqindja është e përcaktueshme me kalibrim, testi ose llogaritje matematikore pasi që instrumentet të jenë kthyer në shërbim; ose

- (b) duke llogaritur Neto Energjinë Elektrike të Liferuar bazën në liferimet gjatë periudhave paraprake në kushte të ngjashme kur instrumentet kanë qenë duke operuar saktë.

6.9 Për aq sa periudha rregulluese mbulon periudhën e liferimeve për të cilat pagesa veç është bërë nga Blerësi, Blerësi duhet të llogaris prapë shumën që duhet paguar për periudhën e pasaktësisë dhe duhet të zbres pagesat e kaluara nga Blerësi për një periudhë të tillë nga shuma e tillë e llogaritur përsëri. Nëse diferenca është numër pozitiv, kjo diferencë duhet të paguhet nga Blerësi tek Prodhuesi. Nëse diferenca është një numër negativ, kjo diferencë duhet të paguhet nga Prodhuesi tek Blerësi. Pagesa e një difference të tillë nga Pala që ka borxh do të bëhet brenda periudhës kohore të specifikuar në Nenin 8 këtu.

[Dy paragrafët e mëposhtëm janë të zbatueshëm vetëm për MBE të nënshkruar me Gjeneratorët me Erë]

6.10 Prodhuesi duhet të instaloj Sistemin e Anemometrit në Kompleks për të matur dhe regjistruar, i pa ndikuar nga efekti i zgjimit të Njësisë Gjeneruese, rrjedhjen e lirë të erës në Vendndodhje në drejtimin mbizotërues të erës. Sistemi i Anemometrit duhet të instalohet, kalibrohet, testohet, mirëmbahet dhe operohet, dhe të gjitha të dhënat e mbledhura përmes Sistemit të Anemometrit duhet të mblidhen, mostërohen, procesohen dhe raportohen në përputhje me standardet e aplikueshme IEC, veçanërisht IEC 61400-Pjesa 12.

6.11 Nëse Blerësi beson se Sistemi i Anemometrit është i pasaktë ai duhet të informoj Operatorin e Sistemit, dhe nëse Operatori i Sistemit vërteton një pohim të tillë, nga Prodhuesi kërkohet që të testoj saktësinë e Sistemit të Anemometrit, dhe Prodhuesi duhet të testoj Sistemin e Anemometrit brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Operatori i Sistemit duhet ti dërgoj Blerësit një njoftim paraprak jo më pak se dyzet e tetë (48) or të një testi të tillë dhe Blerësi duhet të ketë të drejtën të jetë dëshmitar i një testi të tillë, si dhe çdo inspektimi të Sistemit të Anemometrit ose përshtatjeve të tij; me kusht që nëse Blerësi nuk merr pjesë në teste të tilla, inspektime apo përshtatje, nga e drejta e tillë është hequr dorë në lidhje me testet, inspektimet dhe/ose përshtatjet e tilla. Blerësi do të bartë koston e një testi shtesë të kërkuar nga vetë ai, përveç nëse testi tregon që Sistemi i Anemometrit është i pasaktë për më shumë se një përqind (1%), në të cilin rast Prodhuesi duhet të mbuloj kostot e testit shtesë.

7. TELEKOMUNIKIMET

7.1 Jo më vonë se tridhjetë (30) Ditë para Datës së Operimeve Komerciale dhe në çdo rast, përpara se Neto Energjia Elektrike e Liferuar është liferuar nga Gjeneratori në Pikën Kyçëse, Prodhuesi duhet me kosto dhe shpenzime të vetat të blej dhe të instaloj dhe të këto operacionale pajisjet e mëposhtme:

- (a) Një njësi komunikuese në dhomën kontrolluese të Gjeneratorit, ose në ndonjë lokacion tjetër të caktuar nga Prodhuesi, në përputhje me Operatorin e Sistemit për të lejuar komunikimin me zë në mes të Gjeneratorit dhe Qendrës Kontrolluese të Operatori të Sistemit; dhe

- (b) Pajisje të dizajnuara nga Prodhuesi për të transmetuar dhe pranuar faksimile brenda Gjeneratorit, ose në një lokacioni tjetër.
- 7.2 Të gjitha detajet e informatave kontaktuese të Blerësit dhe Prodhuesit, të cilat kërkohen për qëllime komunikimi sipas Nenit 7.1 më sipër, duhet të jepen me shkrim nga të dyja Palët tek Operatori i Sistemit para Datës së Operimeve Komerciale.
- 7.3 Përveç Nenit 7.1, gjatë Afatit të Marrëveshjes, Prodhuesi duhet të instaloj çdo pajisje tjetër të nevojshme sa i përket komunikimit në përputhje me Kodet Relevante.
- 7.4 Të gjitha komunikimet e bëra në mes të Prodhuesit dhe Operatorit të Sistemit, përfshirë komunikimet nga Prodhuesi ku deklaron paaftësinë e pjesshme ose të plotë të Gjeneratorit të veprojnë në pajtim me Udhëzimet e Dispeçimit (së bashku me arsyet për një gjë të tillë), duhet të regjistrohen nga Prodhuesi dhe një kopje e transkriptimit të regjistrimit të tillë duhet të sigurohet për Blerësin sipas kërkesës.
- 7.5 Kërkesat e komunikimit për stabilimentet që ofrojnë shërbime ndihmëse do të jenë të specifikuar në marrëveshjen për shërbime ndihmëse ashtu siç kërkohet në Kodet Relevante.

8. FATURIMI DHE PAGESA

- 8.1 Në bazë të Nenit 9 dhe në përputhje me procedurat e specifikuar në Nenin 8.4 Blerësi do të paguajë Prodhuesin, për detyrimet Mujore, Pagesat e Energjisë, për Energjinë Mujore.
- 8.2 Në ose pas Ditës së pestë (5) të Punës por jo më vonë se Dita e dhjetë (10) e Punës e secilit Muaj, Prodhuesi duhet të dorëzoj faturën tek Blerësi të deklaruar në Euro për Pagesën e Energjisë Mujore që duhet paguar për Muajit paraprak (ose pjesë-Muaji). Fatura e tillë do të përcaktojë Çmimin e Energjisë (siç përcaktohet në përputhje me Shtojcën 1) të Muajit relevant, dhe Neto Energjinë Elektrike të Liferuar, dhe informata të tilla dhe llogaritje përfshirë normën e inflacionit të përcaktuar nga ZRRE në përputhje me Rregullën për Skemën Mbështetëse, në detaje të arsyeshme, në mënyrë që t'i mundësojë Blerësit të konfirmoj se llogaritja e shumave të shfaqura në faturë është në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje.
- 8.3 Blerësi mund të kërkojë sqarime ose vërtetimin e ndonjë shume të përfshirë në një faturë të dorëzuar sipas Nenit 8.2 duke dërguar një njoftim për një kërkesë të tillë tek Pala tjetër. Pala e cila pranon një kërkesë të tillë duhet të jap sqarimet dhe vërtetimet e kërkuara të faturës së tillë ose një deklaratë brenda pesë (5) Ditëve të Punës që nga pranimi i kërkesës së tillë.
- 8.4 Në bazë të Nenit 9:
- (a) Blerësi duhet t'i paguajë Prodhuesit shumën e paraqitur në një faturë të dorëzuar në përputhje me Nenin 8.2, minus zbritjen për ndonjë shumë të Kontestuar, kostot e balancimit, ose pjesë të shumave të paraqitura në faturë, në ose para Ditës së tridhjetë (30) pas Ditës së pranimit të faturës nga Blerësi (“**Data për**

Pagesë dhe e Pagueshme”); me kusht që, nëse një datë e tillë nuk është Ditë Pune, Data e Pagesës dhe e Pagueshme duhet të jetë dita e ardhshme e Punës.

- (b) Çdo faturë e dorëzuar sipas Nenit 8 do të paguhet në Euro.
- (c) Secila Palë ka të drejtën e kompensimit të ndonjë shume për pagesë dhe të pagueshme tek Pala tjetër sipas kësaj Marrëveshje kundrejt ndonjë ose të tërë shumës për pagesë dhe të pagueshme ndaj tij nga Pala tjetër sipas kësaj Marrëveshje. Të drejtat e tilla për kompensim duhet të lidhen vetëm me shumat që janë për pagesë dhe të pagueshme për dhe nga Pala dhe nuk janë të kontestueshme ose që janë përcaktuar si të pagueshme përmes arbitrazhit.
- (d) Pagesat me vonesë nga cilado Palë, e shumave për pagesë dhe të pagueshme, sipas kësaj Marrëveshje duhet të bartin interes prej një norme vjetore të barabartë me Normën e Pagesave të Vonuara, të përlllogaritur në baza Ditore.
- (e) Pagesat e pranuar nga cilado Palë duhet të zbatohen kundrejt faturës së papaguar sipas parimit ‘e para brenda, e para jashtë’, kështu që faturat që kanë mbetur të papaguara për kohën më të gjatë (në tërësi ose pjesërisht) do të paguhet të parat.

8.5 Prodhuesi duhet të mbajë regjistra dhe të dhëna të sakta dhe të plota, siç mund të jetë arsyeshëm e nevojshme për të llogaritur ose konfirmuar saktësinë e, Çmimit të Energjisë, Pagesave të Energjisë, dhe kërkesave tjera për pagesë ose kthim të kostove ose shpenzimeve të bëra nga Prodhuesi sipas kësaj Marrëveshje. Të gjitha të dhënat dhe regjistrat e tilla duhet të mbahen për një periudhë jo më shkurtë se tridhjetë e gjashtë (36) muaj pas datës së fundit në të cilën të dhënat dhe informatat e tilla kanë qenë relevante për kërkesa nga Prodhuesi për pagesë nga Blerësi.

9. MOSMARRËVESHJET PËR PAGESË

9.1 Në çdo kohë brenda tridhjetë (30) Ditësh pas pranimit të një fature, një Palë mund të dërgoj një njoftim (“**Njoftim për Kontestim të Faturës**”) tek Pala tjetër se shuma e faturës së tillë (ose një pjesë e saj) kontestohet. Secili Njoftim për Kontestim të Faturës duhet të specifikoj faturën në fjalë dhe shumën e kontestueshme, duke dhënë arsye sa më të kompletuara dhe të detajuara që të jetë e mundur arsyeshëm. Shumat e kontestuar nuk do të bëhen shuma për Pagesë dhe të Pagueshme derisa të zgjidhjet Kontestimi në përputhje me Nenin 39. Pala ka të drejtë që të dorëzoj çdo Kontestim në lidhje me një faturë për Zgjidhje të Mosmarrëveshjeve në përputhje me Nenin 39 në çoftë se veç ka dorëzuar një Njoftim për Kontestim të Faturës tek Pala tjetër.

9.2 Pas zgjidhjes së Mosmarrëveshjes sipas Nenit 39 çdo shumë e kontestuar dhe që nuk është paguar por është përcaktuar që është borxh ndaj Palës ose çdo shumë e paguar dhe e përcaktuar që nuk ka qenë borxh duhet të paguhet ose paguhet përsëri tek Pala tjetër, siç mund të jetë rasti, brenda shtatë (7) Ditë Pune pas një zgjidhje ose përcaktimi të tillë, së bashku me interesin por duke përjashtuar ditën kur fillimisht është bërë borxh ose paguar deri më dhe përfshirë datën e pagesës ose ri-pagesës, siç mund të jetë rasti, në Normën e Pagesës së Vonuar.

10. PROGRAMI PËR TESTIME

- 10.1 Prodhuesi duhet të siguroj vazhdimisht informata relevante për Operatorin e Sistemit në lidhje me Programin e vetë për Testime dhe duhet të japë programin final për testet në fjalë, duke përfshirë kohëzgjatjen e pritshme dhe një orar tentativë, jo më vonë se tridhjetë (30) Ditë para fillimit të testeve të tilla. Prodhuesi duhet t'i tregoj Operatorit të Sistemit me shkrim për ndonjë ndryshim në orarin e tij final për testet në fjalë jo më vonë se shtatë (7) Ditë para fillimit të testeve. Një orar i tillë final nuk do të rris materialisht ose negativisht kohën e obligimeve të Blerësit sipas kësaj Marrëveshje pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Blerësi.
- 10.2 Prodhuesi duhet të informojë Operatorin e Sistemit që Testet, të cilat mund të kryhen para sinkronizimit të Gjeneratorit me Operatorin e Sistemit të kryhen në prezencë të Operatorit të Sistemit. Programi për Testime do të përfshijë (pa paragjykim ndaj testeve shtesë që kërkohen arsyeshëm nga Operatori i Sistemit) testet e përshkruara në Shtojcën 5.
- 10.3 Operatori i Sistemit do të njoftohet jo më vonë se shtatëdhjetë e dy (72) orë për testet e tilla (dhe ndonjë ri-testim) dhe duhet të ketë mundësinë që të jetë prezent dhe të vëzhgojë të gjitha testet e tilla.

11. DISPONUESHMËRIA DHE KOMISIONIMI I NJËSISË GJENERUESE

- 11.1 Pas marrëveshjes së përbashkët rreth kohës për Programin për Testime të referuar në Nenin 10 dhe posa që prodhuesi është i kënaqur me atë se Gjeneratori është i aftë për të pasur operime të vazhdueshme, Prodhuesi do t'i jap Operatorit të Sistemit Deklaratën e Disponueshmërisë.
- 11.2 Pas lëshimi të Deklaratës së Disponueshmërisë, por në çdo rast jo më vonë se Ditën në vijim, Prodhuesi duhet të kërkoj nga Operatori i Sistemit të jap energji dhe të mbaj me energji Stabilimentet Kyçëse për pranim të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar.
- 11.3 Prodhuesi ka të drejtë të filloj dhe Blerësi do të jetë i obliguar të pranoj liferimet e Neto Energjisë Elektrike të Liferuar në Pikat Kyçëse në Ditën pas Datës së Disponueshmërisë. Në çdo kohë pas kësaj, Prodhuesi duhet të kryej, më rastin e parë që ka në dispozicion, testet e përshkruara në Shtojca 5 ("**Testet e Komisionimit**").
- 11.4 Prodhuesi duhet sa më gjatë që është praktike ose e mundshme të njoftoj Operatorin e Sistemit rreth orarit për kryerjen e Testeve të Komisionimit. Aq sa ka mundësi Operatori i Sistemit të jetë në gjendje të jetë prezent dhe të vëzhgoj çdo test të tillë, do të ketë të drejtën që të jetë prezent, duke u siguruar që është në dijeni për ndikimin e rrezikut të Kushteve Klimatike, (i) Prodhuesi mund të kryej Testet e tilla të Komisionimit pasi që mund të kryhen pa prezencën e zyrtarëve nga Operatori i Sistemit, dhe (ii) Prodhuesi do të kërkoj nga Operatori i Sistemit lëshimin e udhëzimeve të pritjes për personelin e tij në nën-stacionin përkatës për të marrë kërkesën e Prodhuesit në një kohë të shkurtër ose njoftimin e menjëhershëm për kryerjen e operacioneve të tilla në Stabilimentet Kyçëse që të mundësoj kryerjen e Testeve të Komisionimit.

- 11.5 Prodhuesi mund të përsërisë Testet e Komisionimit sa herë që të kërkohet nga Prodhuesi dhe derisa Njësiti Gjenerues të përmbush Testet e Komisionimit për të krijuar Datën e Operimeve Komerciale. Njësiti Gjenerues do të konsiderohet i Komisionuar atëherë kur të deklarohet nga Prodhuesi dhe më pas i certifikuar me shkrim nga Operatori i Sistemit.
- 11.6 Operimet Komerciale duhet të ndodhin Ditën e parë pas Ditës kur Gjeneratori është Komisionuar.
- 11.7 Pavarësisht fillimit të liferimit të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar në Ditën pas Ditës së Disponueshmërisë por para Datës së Operimeve Komerciale, në rast se ndonjë Test i Komisionimit demonstroi se ka defekt, gabim, pamjaftueshmëri në dizajn ose ndërtim ose defekt ose gabim në operim të (i) çdo pajisje të sigurisë dhe mbrojtëse që përbëjnë Stabilimentet Kyçëse të Prodhuesit, (ii) sistemit për rregullimin e tensionit, (iii) shëndrruesi elektrik i energjisë, (iv) sistemi reaktiv i kompensimit, ose (v) ose ndonjë pajisje tjetër në Gjenerator që, në cilindo rast, shkakton Emergjencë, apo ka shumë gjasë që të shkaktoj një Emergjencë, Operatori i Sistemit mund të kërkojë nga Prodhuesi që të ndërpres liferimin e Neto Energjisë Elektrike të Liferuar në Pikën Kyçëse derisa defekti ose gabimi të jenë larguar. Prodhuesi në atë rast duhet të ndërmarrë masa të tilla rregulluese që mund të jenë të nevojshme dhe të përshtatshme për t'u siguruar që Gjeneratori operon në përputhje me kërkesat e sigurisë, teknike dhe funksionale të përshkruara në këtë Marrëveshje. Pas konfirmimit nga Operatori i Sistemit se masat e duhura rregulluese janë zbatuar nga Prodhuesi, Blerësi duhet të vazhdojë pranimin e Neto Energjisë Elektrike të Liferuar në Pikën Kyçëse.
- 11.8 Prodhuesi duhet të sigurojë për Operatorin e Sistemit kopjet e rezultateve të Testit të Komisionimit dhe rezultatet e testit pas secilit riparim gjeneral të ndonjë Njësie Gjeneruese ose ndonjë pajisje tjetër të madhe në Gjenerator.
- 11.9 Nëse, gjatë ose pas Ndërprerjes së Planifikuar, Ndërprerjes për Mirëmbajtje, Ngjarjes së Forcës Madhore, nga Prodhuesi kërkohet që të kryej disa teste shtesë të një ose më shumë Njësive Gjeneruese ose të Gjeneratorit të cilat nuk kërkohen sipas këtij Neni 11.9 dhe të cilat kërkojnë që energjia elektrike të liferohet te Operatori i Sistemit. Prodhuesi, në përputhje me Kodet Relevante, do të kërkojë nga Operatori i Sistemit që të përshtat testet e tilla sa më shpejt që të jetë e arsyeshme nga ana praktike pas një kërkesë për një gjë të tillë.
- 11.10 Deri në atë masë sa mund të kërkohet ndonjë test shtesë për Gjeneratorin bazuar në Kodin e Rrjetit ose Marrëveshjen për Kycje, Prodhuesi do të kryej teste të tilla kur të kërkohen.
- 11.11 Prodhuesi do të operoj dhe mirëmbaj Gjeneratorin në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje, Legjislacionin e Kosovës, Kodet Relevante, Kodin e Matjes dhe Praktikën e Matura të Shfrytëzimit. Obligimet e Prodhuesit do të përfshijnë, pa u kufizuar:
- (a) Prodhuesi do të operoj me Gjeneratorin paralel me Operatorin e Sistemit në përputhje me Kodet Relevante në lidhje me sinkronizimin, tensionin dhe kontrollin e frekuencës dhe gjenerimin e frekuencave të harmonizuara.

- (b) E tërë Neto Energjia Elektrike e Liferuar nga Gjeneratori në Pikën Kyçëse duhet të ketë të gjitha karakteristika elektrike të përcaktuara në Kodet Relevante.
 - (c) Operimi i linjës së transmisioni dhe/ose sinkronizimi i ndërprerësit të qarkut do të ndodhë nën drejtimin e Qendrës Kontrolluese të Operatorit të Sistemit në përputhje me dispozitat e Kodeve Relevante. Pas njoftimit të arsyeshëm, me përjashtim të kushteve Emergjente ku nuk kërkohet një njoftim paraprak, Prodhuesi do të lejoj çdo punonjës dhe inspektorë të Operatorit të Sistemit që të kryej teste të tilla të operimit dhe inspektime aq sa konsiderohen të nevojshme nga Operatori i Sistemit për të konstatuar se pajisjet e linjës së transmisionit që lidhen me Stabilimentet Kyçëse janë duke funksionuar si duhet. Blerësi duhet të bartë të gjitha kostot dhe shpenzimet e arsyeshme të inspektimeve dhe testeve të tilla.
- 11.12 Prodhuesi do të jetë përgjegjës për disponueshmërinë mekanike dhe elektrike të Gjeneratorit dhe komponentëve të tij për gjenerim të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar gjatë gjithë Afatit. Prodhuesi do të jetë përgjegjës për atë që kurdo që Kushtet Klimatike lejojnë gjenerim në Vendndodhje dhe liferim të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar në Pikën Kyçëse, përveç kur dhe deri në atë masë sa gjenerimi dhe liferimi i Neto Energjisë Elektrike të Liferuar pengohet pjesërisht ose plotësisht gjatë vazhimit të ose në llogari të Ngjarjes së Forcës Madhore, Ndërprerjes së Planifikuar ose Ndërprerjes për Mirëmbajtje ose Ngjarje që nuk kanë të bëjnë me Projektin.
- 11.13 Në rast se Prodhuesi kontraktton një Kontratorë O&M që të operoj dhe mirëmbaj Gjeneratorin; kjo nuk do të liroj Prodhuesin nga asnjë prej obligimeve të tij dhe detyrimeve potenciale në lidhje me sigurimin, operimin ose mirëmbajtjen e Gjeneratorit ose ndonjë detyrim çfarëdo çoftë që rezulton nga shkelja e ndonjë afati ose kushti të kësaj Marrëveshje.
- 11.14 Operatori i Sistemit do të ketë të drejtën, në mënyrë të përsëritshme dhe me një njoftim të arsyeshëm paraprak tek Prodhuesi që të dërgoj zyrtarët, punonjësit dhe përfaqësuesit e Operatorit të Sistemit që të vëzhgojnë operimin e secilës Njësi Gjeneruese. Prodhuesi do të pajtohet me të gjitha kërkesat e arsyeshme të Operatorit të Sistemit për, dhe të ndihmoj në aranzhimin e vizitave të tillë vëzhguese. Vizitat e Operatorit të Sistemit do të jenë të arsyeshme si për nga shpeshtësia e vizitave të tilla po ashtu edhe nga numri i personave. Të gjithë personat që vizitojnë Gjeneratorin, ose Vendndodhjen në emër të Operatorit të Sistemit duhet të veprojnë në përputhje me rregulloret dhe procedurat e sigurisë që janë vënë në dispozicion për personat e tillë dhe duhet të veprojnë në përputhje me udhëzimet dhe drejtimet e arsyeshme të Prodhuesit, dhe nuk duhet që pa arsye të shkaktojnë ndërhyrje ose ndërprerje në aktivitetet e Prodhuesit në Vendndodhje.

12. PARASHIKIMI I NETO ENERGJISË ELEKTRIKË TË LIFERUAR

- 12.1 Prodhuesi pajtohet se do të përdorë mjetet më të mira të mundshme që janë në dispozicion, dhe në përputhje me Kodet Relevante dhe Praktikën e Matura të Shfrytëzimit, duke u bazuar në të dhënat e kufizuara historike, oraret e mirëmbajtjes,

dhe të dhënat tjera relevante që duhet të merren parasysh, që të parashikoj disponueshmërinë afatgjate dhe afatshkurtër të Gjenerimit dhe bazuar në atë do të siguroj për Blerësin të dhënat jo-detyruese për çdo orë si në vijim:

- (a) jo më vonë se tridhjetë (30) Ditë para fillimit të secilit Vit të Marrëveshjes, parashikimin për vitin përpara të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar në baza Mujore për Vitin pasues të Marrëveshjes;
- (b) jo më vonë se një (1) Javë para fillimit të secilit Muaj, parashikimin për muajin përpara të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar në baza Javore për Muajin pasues; dhe
- (c) jo më vonë se në ora 09:00 çdo ditë, parashikimi për ditën përpara për Neto Energjinë Elektrike të liferuar për ditën në vijim.

12.2 Çdo ndryshim i rëndësishëm nga parashikimet e mësipërme duhet të shënohet dhe të jepet një shpjegim nga Prodhuesi për Blerësin, dhe duhet të jetë në përputhje me Kodet Relevante.

13. UDHËZIMET E DISPEÇIMIT

13.1 Prodhuesi duhet të jetë në përputhje me Udhëzimet e Dispeçimit të lëshuara nga Blerësi, me kusht që:

- (a) Udhëzimet e tilla të Dispeçimit janë në përputhje me Kufizimet Teknike; dhe
- (b) Gjeneratori mund të operojë në përputhje me Udhëzimet e Dispeçimit sa i përket Kushteve mbizotëruese Klimatike.

13.2 Prodhuesi nuk konsiderohet se ka shkelur Nenin 13.1 për mosekzekutim të Udhëzimit të Dispeçimit për shkak të Ngjarjes që nuk ka të bëjë me Projektin.

13.3 Pajtueshmëria me Udhëzimet e Dispeçimit është kusht material i kësaj Marrëveshje – dështimi i përsëritur nga Prodhuesi për të qenë në përputhje me Udhëzimet e Dispeçimit do të përbëjë një Ngjarje të Mospërmbushjes së Prodhuesit.

13.4 Gjatë Afatit të kësaj Marrëveshje, Prodhuesi do të ngarkohet për Balancim, sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, Rregullës për Skemën Mbështetëse dhe Rregullat relevante të Tregut.

14. NDËRPRERJA E PLANIFIKUAR

14.1 Prodhuesi duhet të siguroj një orar për Ndërprerjet e Planifikuara të Gjeneratorit për vitin e parë të operimit së paku tridhjetë (30) ditë para Datës së Komisionimit. Pas kësaj, Prodhuesi do të dorëzoj tek Blerësi Orarin vjetor të Ndërprerjeve jo më vonë se me 1 Tetor të secilit vit që mbulon periudhën dymbëdhjetë (12) mujore duke filluar me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor dhe një parashikim për Ndërprerjet e Planifikuara afatgjate që do të përfshijnë katër (4) vitet e menjëhershme të mirëmbajtjes. Çdo Ndërprerje e Planifikuar do të jetë në përputhje me kufizimet e përcaktuara në Nenin 14.2. Blerësi do të jap njoftim me shkrim për ndonjë kundërshtim të arsyeshëm në

Orarin Vjetor të Ndërprerjeve brenda dhjetë (10) Ditë Pune pas pranimit të tij, dhe nëse nuk pranohet një kundërshtim i tillë do të konsiderohet si miratim i Orarit vjetor të Ndërprerjeve. Prodhuesi duhet ti jap Blerësit një njoftim të arsyeshëm paraprak për ndonjë ndryshim në Orarin vjetor të Ndërprerjeve. Njoftimi i arsyeshëm paraprak për ndonjë ndryshim në Orarin vjetor të Ndërprerjeve që përfshinë ndonjë ndalje të komplet Gjeneratorit është si në vijim:

Kohëzgjatja e Pritshme e Ndërprerjes së Planifikuar	Njoftimi Paraprak për Blerësin
(1) Më pak se 2 ditë	së paku 24 orë
(2) 2 deri 5 ditë	së paku 7 ditë
(3) Riparime të mëdha (mbi 5 ditë)	së paku 90 ditë

- 14.2 Prodhuesi nuk do të planifikoj ndonjë Ndërprerje të Planifikuar për komplet Gjeneratorin gjatë çdo dite të javës të një Muaji të Pikut pa miratimin paraprak me shkrim nga Blerësi i cili nuk duhet të refuzohet, vonohet ose vazhdohet pa arsye.
- 14.3 Blerësi do të siguroj një orar të mirëmbajtjeve për stabilimentet shpërndarëse afër Stabilimenteve Kyçëse për vitin e parë të operimit së paku tridhjetë (30) ditë para Datës së Komisionimit. Pas kësaj, Blerësi duhet të dorëzoj tek Prodhuesi orarin vjetor të mirëmbajtjes jo më vonë se 31 Janari i secilit vit që mbulon periudhën dymbëdhjetë (12) mujore duke filluar me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

15. NDËRPRERJET PËR MIRËMBAJTJE

- 15.1 Prodhuesi do të njoftojë Blerësin për nevojën e ndonjë Ndërprerje për Mirëmbajtje, së bashku me datën e propozuar për fillim dhe kohëzgjatjen e vlerësuar të punëve që do të kryhen. Prodhuesi do të njoftojë Blerësin për periudhën gjatë së cilës një Ndërprerje për Mirëmbajtje mund të kryhet, periudhat e tilla do të jenë të arsyeshme për sa i përket kërkesave të Blerësit për Neto Energji Elektrike të Liferuar dhe nevojës për Ndërprerje për Mirëmbajtje. Prodhuesi, subjekt i Kufizimeve Teknike, do të përdor përpjekjet e arsyeshme që të përfundoj Ndërprerjen për Mirëmbajtje gjatë kohës së dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 14.3.
- 15.2 Prodhuesi do të bashkëpunoj me Blerësin në zhvillimin e procedurave emergjente për Gjeneratorin, duke përfshirë zvogëlimin e tensionit për të ndikuar në Reduktim të ngarkesës, dhe do të, në përputhje me Kufizimet Teknike, jetë në përputhje me procedurat emergjente.

16. PUNËSIMI I PERSONELIT TË KUALIFIKUAR

- 16.1 Nga dhe pas datës së parë të liferimit të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar nga Gjeneratori në Pikën Kyçëse, Prodhuesi dhe Blerësi do të sigurohen që personeli i tyre dhe/ose Kontraktorët e tyre të jenë në detyrë të Gjeneratori respektivisht Qendra Kontrolluese, gjatë tërë kohës, dhe se personeli i tillë është në mënyrë adekuate i kualifikuar dhe trajnuar, dhe të cilët kanë përvojë si të nevojshme ashtu edhe të

përshatshme për të ndërmarrë detyrat për të cilat janë të angazhuar tek Gjeneratori dhe Qendra Kontrolluese e Operatorit të Sistemit.

17. MIRËMBAJTJA E REGJISTRAVE TË OPERIMIT

- 17.1 Secila Palë duhet të mbajë regjistra të kompletuar dhe të saktë dhe me të gjitha të dhënat tjera që mund të kërkohen arsyeshëm për administrimin e duhur të kësaj Marrëveshje.
- 17.2 Pa paragjykuar përgjithësimin e mësipërm, Prodhuesi duhet të mbajë një dokument regjistruar operativ të saktë dhe të azhurnuar, në një format të rënë dakord reciprokisht nga Palët, në Vendndodhje me shënime dhe të dhëna të:
- (a) gjenerimi bruto i energjisë elektrike nga secila Njësi Gjeneruese për çdo orë;
 - (b) Neto Energjia Elektrike e Liferuar;
 - (c) Të dhënat e disponueshmërisë së Njesisë Gjeneruese për çdo orë;
 - (d) Shpejtësia aktuale e erës e matur në anemometrën e instaluar në Njësinë Gjeneruese;
 - (e) Ndërprerjet e mirëmbajtjes së planifikuara dhe të paplanifikuara;
 - (f) Operimet e lëshimit të ndërprerësit së qarkut që kërkon një reset manual;
 - (g) Nën-ngarkimi i pjesshëm i pajisjeve;
 - (h) Ngjarje tjetër domethënëse që lidhet me operimin e Gjeneratorit; dhe
 - (i) Çështje tjera të rena dakord nga Palët.
- 17.3 Prodhuesi duhet të dorëzoj tek Blerësi një raport mujor, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të secilit muaj kalendarik, me informatat e listuara në paragrafët (a) deri (i) më sipër në një formë të tillë që mund të kërkohet arsyeshëm nga Blerësi.
- 17.4 Secila Palë do të ketë të drejtën, pas njoftimit me shkrim dhjetë (10) Ditë më parë për Palën tjetër, që të shqyrtoj regjistrat dhe të dhënat e mbajtura nga Pala tjetër sipas Nenit 17.1 dhe 17.2 në çdo kohë gjatë orarit zyrtar gjatë një periudhe të tillë për sa kërkohet të mbahen regjistrat dhe të dhënat e tilla. Për të shmangur dyshimet, është rënë dakord që referenca për regjistra dhe të dhëna në Nenin 17.4 përfshinë regjistrat dhe të dhënat e krijuara, regjistruara, mirëmbajtura dhe të marra në formë elektronike.
- 17.5 Të gjithë regjistrat dhe të dhënat e përmendura në Nenin 17 duhet të mirëmbahen për minimum gjashtëdhjetë (60) Muaj pas krijimit të regjistrave dhe të dhënave të tilla dhe për ndonjë kohë më të gjatë e cila mund të kërkohet nga ndonjë Entitet i Sektorit Publik që ka juridiksion në cilëndo Palë dhe asnjëra Palë nuk do të hedh ose shkatërroj ndonjë prej regjistrave ose të dhënave të tilla pas një periudhe të tillë gjashtëdhjetë (60) Mujore përveç nëse Pala që dëshiron të hedhë apo shkatërroj ndonjë regjistër apo të dhënë të tillë ka dhënë fillimisht njoftimin paraprak me shkrim prej tridhjetë (30) Ditësh për Palën tjetër, ku në përgjithësi përshkruan regjistrat dhe të dhënat që do të hedhen ose shkatërrohen dhe se Pala që ka pranuar një njoftim të tillë nuk e ka kundërshtuar atë me shkrim brenda dhjetë (10) Ditësh.

18. NGJARJET E MOS PËRMBUSHJES NGA PRODHUESI

18.1 Ngjarjet në vijim do të jenë ngjarje të mos përmbushjes nga Prodhuesi (secila “**Ngjarje e Mos përmbushjes nga Prodhuesi**”), me kusht që, asnjë ngjarje e tillë nuk do të jetë Ngjarje e Mos përmbushjes nga Prodhuesi nëse shkaktohet plotësisht ose pjesërisht nga shkelja e Blerësit, ose mos përmbushje nga Blerësi sipas kësaj Marrëveshje (duke përfshirë çdo Ngjarje të Mos përmbushjes nga Blerësi), ose nëse ndodhë si rezultat i Ngjarjes së Forcës Madhore:

- (a) dështimi i Prodhuesit për të arritur Datën e Operimeve Komerciale jo më vonë se dyqind (200) Ditë pas Datës Efektive;
- (b) pas Datës së Operimeve Komerciale, një Braktisje nga Prodhuesi pa pëlqim paraprak me shkrim të Blerësit dhe e cila vazhdon për një periudhë prej tridhjetë (30) Ditëve të njëpasnjëshme;
- (c) çdo shkelje e obligimeve të tij nga Prodhuesi sipas Nenit 23 (*Transferimi*) ose Neni 11.12 (*Disponueshmëria e Gjeneratorit*);
- (d) përveç për qëllim të bashkimit ose rindërtimit që nuk ndikon në aftësinë e entitetit të bashkuar ose rindërtuar, siç mund të jetë rasti, për të kryer obligimet sipas kësaj Marrëveshje, shfaqja e ndonjëres nga ngjarjet e mëposhtme:
 - (i) çdo masë e vendosur në mënyrë të vlefshme sipas Legjislacionit të Kosovës për shpërbërje të Prodhuesit e cila nuk është shtyrë ose suspenduar për nëntëdhjetë (90) Ditë;
 - (ii) kalimi i një rezolute për shpërbërjen ose mbylljen e Prodhuesit;
 - (iii) deklarimi vullnetarë nga Prodhuesi për petition për mbyllje, ose kërkesë për moratorium për pagesë borxhi ose lehtësime tjera të ngjashme;
 - (iv) emërimi i një likuiduesi të përkohshëm në një masë për mbyllje të Prodhuesit pas njoftimit të Prodhuesit dhe seancës së duhur dëgjimore, i cili emërim nuk është lënë mënjanë ose ndaluar brenda nëntëdhjetë (90) Ditëve të një emërimi të tillë; ose
 - (v) krijimi i një urdhërese nga gjykata që ka juridiksion mbi Prodhuesin për mbyllje të Prodhuesit e cila urdhëresë nuk është ndaluar ose anuluar nga gjykata me juridiksion kompetent brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh;
- (e) çdo deklaratë, përfaqësim ose garanci e bërë nga Prodhuesi në këtë Marrëveshje që vërtetohet se ka qenë jo korrekte, në çdo aspekt material, kur është bërë apo kur rikonfirmohet dhe një deklaratë, përfaqësim ose garanci e tillë që ka efekt material negativ në aftësinë e Prodhuesit për të kryer obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshje ose ka efekt material negativ në të drejtat ose obligimet e Blerësit sipas kësaj Marrëveshje;
- (f) çdo shkelje materiale ose mospërmbushje materiale nga Prodhuesi i kësaj Marrëveshje (përveç ndonjë shkelje ose mospërmbushje e referuar në nën-Nenet tjera të Nenit 18), përfshirë çdo shkelje materiale ose mospërmbushje në kryerjen e obligimeve të veta për të vepruar në përputhje me Praktikën e Matura të Shfrytëzimit, e cila nuk është rregulluar brenda tridhjetë (30) Ditësh pas

njoftimit nga Blerësi, duke deklaruar se shkelja materiale ose mospërmbushja sipas kësaj Marrëveshje ka ndodhur dhe është duke vazhduar dhe identifikimi i shkeljes materiale dhe mospërmbushjes në fjalë në detaje të arsyeshme; ose

- (g) ngatërrimi në tri (3) ose më shumë raste të ndara nga Prodhuesi ose kontraktorët e tij ose punëtorët e tij duke vepruar brenda aktivitetëve të punës së tyre me Sistemin e Matjes.

19. NGJARJET E MOS PËRMBUSHJES NGA BLERËSI

19.1 Ngjarjet në vijim do të jenë ngjarje të mospërmbushjes nga Blerësi (secila “Ngjarja e Mos përmbushjes nga Blerësi”); me kusht që, asnjë ngjarje e tillë nuk do të jetë Ngjarje e Mos përmbushjes nga Blerësi nëse shkaktohet plotësisht ose pjesërisht nga shkelja e Prodhuesit, ose mospërmbushje nga Prodhuesi sipas kësaj Marrëveshje (duke përfshirë çdo Ngjarje të Mospërmbushjes nga Prodhuesi), ose nëse ndodhë si rezultat i Ngjarjes së Forcës Madhore:

- (a) dështimi i Blerësit për të paguar ndonjë shumë që është për t’u paguar nga ai sipas dispozitave të Nenit 8 të kësaj Marrëveshje deri në Datën për Pagesë dhe të Pagueshme për faturën përkatëse apo të bëj ndonjë pagesë tjetër kur të kërkohet, në çdo rast, që nuk është rregulluar brenda tridhjetë e pesë (35) Ditë pas pranimit të njoftimit nga Prodhuesi tek Blerësi duke deklaruar se ka ndodhur mospërmbushja e pagesës dhe vazhdon dhe përshkruan një mospërmbushje të një pagese të tillë në detaje të arsyeshme;
- (b) përveç për qëllim të bashkimit ose rindërtimit që nuk ndikon në aftësinë e entitetit të bashkuar ose rindërtuar, siç mund të jetë rast, për të kryer obligimet sipas kësaj Marrëveshje, shfaqja e ndonjëres nga ngjarjet e mëposhtme:
 - (i) çdo masë e vendosur në mënyrë të vlefshme sipas Legjislacionit të Kosovës për shpërbërje të Blerësit e cila nuk është shtyrë ose suspenduar për nëntëdhjetë (90) Ditë ;
 - (ii) kalimi i një rezolute për shpërbërjen ose mbylljen e Blerësit;
 - (iii) deklarimi vullnetarë nga Blerësi për peticion për mbyllje;
 - (iv) emërimi i një likuiduesi të përkohshëm në një masë për mbyllje të Blerësit pas njoftimit të Blerësit dhe seancës së duhur dëgjimore, i cili emërim nuk është lënë mënjanë ose ndaluar brenda nëntëdhjetë (90) Ditëve të një emërimi të tillë; ose
 - (v) krijimi i një urdhërese nga gjykata që ka juridiksion mbi Blerësin për mbyllje të Blerësit e cila urdhëresë nuk është ndaluar ose anuluar nga gjykata me juridiksion kompetent brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh;
- (c) çdo deklaratë, përfaqësim ose garanci e bërë nga Blerësi në këtë Marrëveshje që vërtetohet se ka qenë jo korrekte, në çdo aspekt material, kur është bërë apo kur rikonfirmohet dhe një deklaratë, përfaqësim ose garanci e tillë që ka efekt material negativ në aftësinë e Blerësit për të kryer obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshje ose ka efekt material negativ në të drejtat ose obligimet e Prodhuesit më poshtë;

- (d) çdo shkelje materiale ose mospërmbushje materiale nga Blerësi i kësaj Marrëveshje (përveç ndonjë shkelje or mospërmbushje e referuar në nën-Nenet tjera të Nenit 19) e cila nuk është rregulluar brenda tridhjetë (30) Ditësh pas njoftimit nga Prodhuesi për Blerësin, duke deklaruar se shkelja materiale ose mospërmbushja sipas kësaj Marrëveshje ka ndodhur dhe është duke vazhduar dhe identifikimi i shkeljes materiale dhe mospërmbushjes në fjalë në detaje të arsyeshme; ose
- (e) ngatërrimi në tri (3) ose më shumë raste të ndara nga Blerësi ose Kontraktorët e tij ose punëtorët e tij duke vepruar brenda aktiviteteve të punës së tyre me Sistemin e Matjes.

20. NJOFTIMI PËR QËLLIMIN E SHKËPUTJES

- 20.1 Nëse ndonjë Ngjarje e Mospërmbushjes nga Prodhuesi ose Ngjarje e Mospërmbushjes nga Blerësi, siç mund të jetë rasti, shfaqet dhe është duke vazhduar, Pala që nuk është mospërmbushëse mund të dorëzojë një njoftim (“**Njoftimi për Qëllimin e Shkëputjes**”) tek Pala mospërmbushëse i cili njoftim duhet të specifikoj në detaje të arsyeshme Ngjarjen e Mospërmbushjes nga Prodhuesi ose Ngjarjen e Mospërmbushjes nga Blerësi, siç mund të jetë rasti, duke ngritur Njoftimin për Qëllimin e Shkëputjes, duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, nëse ngjarja e tillë e mospërmbushjes nuk ndikon në Gjenerator në ndonjë aspekt material.
- 20.2 Përveç shfaqjes së Ngjarjes së Mospërmbushjes, Prodhuesi ka të drejtë që vullnetarisht të shkëpus këtë Marrëveshje, në të cilin rast Prodhuesi mund të dorëzojë një njoftim (“**Njoftim për Qëllimin e Shkëputjes**”) tek Blerësi së paku 6 muaj para fillimit të secilit Vit të Marrëveshjes.
- 20.3 Periudhat e mëposhtme të kurimit (secila një “**Periudhë Kurimi**”) do të zbatohen:
 - (a) Nëse rast të një Ngjarje të Mospërmbushjes nga Blerësi që është ngritur sipas Nenit 19.1(a) Periudha e Kurimit do të jetë dyzetepesë (45) Ditë; dhe
 - (b) Në një rast tjetër të ndonjë Ngjarje të Mospërmbushjes nga Blerësi ose Ngjarje të Mospërmbushjes nga Prodhuesi, siç mund të jetë rasti, Periudha e Kurimit do të jetë nëntëdhjetë (90) Ditë.
 - (c) Nëse rast të njoftimit të Prodhuesit për shkëputje vullnetare të Marrëveshjes, Periudha Kuruese do të jetë njëqind e tetëdhjetë (180) Ditë,në secilin rast nga data relevante kur Njoftimi për Qëllimin e Shkëputjes konsiderohet se është dorëzuar.

21. NJOFTIMI PËR SHKËPUTJE

- 21.1 Në rast se një Palë mospërmbushëse nuk ka, edhe pas pranimit të Njoftimit për Qëllimin e Shkëputjes, rregulluar Ngjarjen e Mospërmbushjes nga Prodhuesi ose Ngjarjen e Mospërmbushjes nga Blerësi, siç mund të jetë rasti, të përshkruara në to para skadimit të Periudhës Kuruese relevante, Pala që nuk është mospërmbushëse mund të shkëpus këtë Marrëveshje duke dorëzuar një njoftim për shkëputje (“**Njoftimi për Shkëputje**”)

tek Pala mospërmbushëse. Kjo Marrëveshje do të shkëputet në datën e specifikuar në Njoftimin për Shkëputje (“**Data e Shkëputjes**”), e cila datë nuk duhet të jetë më herët se data që është dhjetë (10) Ditë Pune pas datës në të cilën është dorëzuar Njoftimi për Shkëputje tek Pala tjetër ose jo më vonë se tridhjetë (30) Ditë pas datës së një dërgese të tillë. Pas çdo shkëputje të kësaj Marrëveshje sipas Nenit 21 dispozitat e Nenit 22 do të zbatohen.

22. OBLIGIMET PAS SHKËPUTJES

- 22.1 Pas skadimit të kësaj Marrëveshje ose shkëputjes së hershme të kësaj Marrëveshje sipas Nenit 21 të gjitha kontratat, obligimet, përfaqësimet, dhe garancitë që përmban kjo Marrëveshje do të shkëputen dhe nuk do kenë fuqi ose efekt dhe Palët nuk do të kenë obligime ose detyrime shtesë sipas kësaj Marrëveshje, përveç atyre obligimeve dhe detyrimeve të cilat kanë dalë para dhe mbesin të papaguara në datën e skadimit ose shkëputjes, dhe ato obligime dhe detyrime të cilat shprehimisht mbijetojnë një skadim ose shkëputje të tillë sipas Nenit 22.2 të kësaj Marrëveshje.
- 22.2 Pavarësisht nga çdo gjë që është në këtë Marrëveshje në të kundërtën, dispozitat e Nenit 17 (*Mirëmbajtja e Regjistrave të Operimeve*), ky Nen 22 (*Të Drejtat dhe Obligimet e Palëve për Shkëputje*), Neni 1 (*Definicionet; Rregullat e Interpretimit*); Neni 25 (*Përgjegjësia*), Neni 39 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) shprehimisht do të mbijetojnë çdo shkëputje ose skadim të kësaj Marrëveshje për një periudhë prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh nga data e një skadimi ose shkëputje të tillë.
- 22.3 Në pajtim me Nenin 22.2, Palët nuk kanë të drejtë të pranojnë, as të paguajnë detyrime, dëme ose kompensime tjera për ose si rezultat i shkëputjes së kësaj Marrëveshje sipas Nenit 22.1 përveç shumave të pagueshme, ose detyrimeve të Palës që dalin prej para një shkëputje të tillë.

23. TRANSFERIMI

- 23.1 Kjo Marrëveshje do të jetë detyruese pas, dhe do të hyj në veprim për përfitim të Palëve dhe pasardhësve përkatës të tyre dhe transferimeve të lejuara. Për më tepër, dhe përveç nëse janë dakorduar ndryshe shprehimisht të dy Palët, asnjë transferim nuk do të lehtësoj transferuesin nga obligimet e tij në rast se i transferuari i tij dështon të kryej obligimet e tij sipas Marrëveshjes.
- 23.2 Përveç për një transferim ose peng të kësaj Marrëveshje tek pala financuese përmes një marrëveshje direkte financimi e lidhur me Prodhuesin për këtë Projekt, Prodhuesi nuk duhet të transferoj këtë Marrëveshje, apo ndonjë prej të drejtave dhe obligimeve në të, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Blerësi, një pajtim i tillë të mos refuzohet paarsyeshëm. Pëlqimi nga ana e Blerësit për një transferim të tillë nuk do të konsiderohet si pëlqim për çdo transferim pasues. Një transferim pa pëlqimin paraprak me shkrim të Blerësit ose një transferim nga veprimi i ligjit do të jetë i pavlefshëm dhe bosh dhe sipas zgjedhjes së Blerësit, do të shkëpus këtë Marrëveshje.

- 23.3 Blerësi mund të ja transferoj këtë Marrëveshje ndonjë entiteti tjetër, pas miratimit me shkrim nga Pala tjetër, i cili nuk duhet të refuzohet paarsyeshëm.

24. MBAJTJA E POLICAVE TË SIGURIMIT

- 24.1 Prodhuesi në kosto dhe shpenzime të veta, do të marrë dhe të mbajë, ose do të shkaktoj të merret dhe mbahet, gjatë Afatit policat e sigurimit të përcaktuara në Shtojcën 4 në shumat e përcaktuara aty dhe gjatë periudhave të cekura aty, me një ose më shumë sigurues që financiarisht qëndrojnë mirë; me kusht që këto shuma mund të ndryshohen kohë pas kohe me një pëlqim paraprak me shkrim të Blerësit; me kusht që, për më tutje, Prodhuesi nuk do të jetë në shkelje të obligimeve të tij më poshtë nëse dhe deri në masë që (i) ndonjë sigurim i veçantë nuk është në dispozicion në kushte të arsyeshme komerciale dhe për norma komerciale të arsyeshme për arsye tjera përveç ndonjë pakujdesi ose mospërbushje nga, ose kusht (financiar ose tjetër) të, Prodhuesit ose (ii) Prodhuesi nuk është në gjendje të marrë (pasi ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme) asnjë mbështetje ose njohje të shkruar që kërkohet sipas kësaj Marrëveshje.

- 24.2 Prodhuesi duhet të bëjë siguruesin e tij ose agjentin të siguroj certifikatën e sigurimit për Prodhuesin që dëshmon politikat dhe mbështetjet e listuara më sipër. Dështimi i Prodhuesit për të marrë mbulimin e sigurimit ose certifikatat e sigurimit që kërkohen nga ky Neni 24 në asnjë mënyrë nuk e liron ose kufizon atë nga obligimet dhe detyrimet e Prodhuesit sipas çdo dispozite të kësaj Marrëveshje. Nëse prodhuesi do dështojë të blej ose mbajë ndonjë sigurim që kërkohet sipas Nenit 24 atëherë Blerësi do të ketë të drejtën të blej një sigurim të tillë në përputhje me kërkesat e Shtojcës 4 dhe do të ketë të drejtën të kompensoj premitë e paguara për një sigurim të tillë kundrejt çdo shume që ja ka borxh Prodhuesit në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje. Prodhuesi duhet të quhet si i paguari humbës në çdo sigurim të tillë të blerë nga Blerësi në pajtim me Nenin 24.2.

25. DËMSHPËRBLIMI DHE PËRGJEGJËSIA

- 25.1 Përveç siç kërkohet në Nenin 25.2 asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Palës tjetër në kontratë, shkelje, garanci, përgjegjësi të rreptë ose ndonjë teori tjetër ligjore për ndonjë dëm indirekt, rrjedhimorë, rastësishëm, ndëshkues ose karakteristik.
- 25.2 Kufizimi[et] e përgjegjësisë së përcaktuara më lartë nuk do zbatohen në rast të mospërbushjes me dashje ose neglizhencës së madhe nga cilado Palë.
- 25.3 Përveç siç është dhënë në mënyrë specifike diku tjetër në këtë Marrëveshje, Blerësi do të dëmshpërblej dhe mbrojë Prodhuesin, për vete dhe si i besuar i zyrtarëve, drejtorëve dhe punonjësve të vetë kundrejt, dhe të mbajë Prodhuesin, zyrtarët, drejtorët dhe punonjësit të padëmshëm prej, gjatë tërë kohës pas kësaj date, nga çdo dhe të gjitha Humbjet e shkaktuara, bëra, të qëndrueshme dhe që kërkohen për t'u paguar, direkt ose indirekt, nga, ose që kërkohet të imponohen në Prodhuesin, zyrtarët, drejtorët ose punonjësit e tij, për lëndime personale ose vdekje të personave ose dëmtrim të pronës që vjen nga ndonjë neglizhencë ose vepër e qëllimshme ose mosveprim nga ana e Blerësit në lidhje me këtë Marrëveshje. Pavarësisht të gjithave që kundërshtohen në

- përmbajtjen e fjalisë së mësipërme, asgjë në Nenin 25.3 nuk do zbatohet për ndonjë Humbje në lidhje me dhe në masën në të cilën Prodhuesi pranon të ardhura nga polica e sigurimit ose dëmshpërblim nga pala tjetër.
- 25.4 Prodhuesi do të shpërblejë dhe mbrojë Blerësin, për vete dhe si i besuar i zyrtarëve, drejtorëve dhe punonjësve të vetë kundrejt, dhe të mbajë Blerësin, zyrtarët, drejtorët dhe punonjësit të padëmshëm prej, gjatë tërë kohës pas kësaj date, nga çdo dhe të gjitha Humbjet e shkaktuara, bëra, të qëndrueshme dhe që kërkohen për t'u paguar, direkt ose indirekt, nga, ose që kërkohet të imponohen në Blerësin, zyrtarët, drejtorët ose punonjësit e tij, për lëndime personale ose vdekje të personave ose dëmtim të pronës që vjen nga ndonjë neglizhencë ose veprë e qëllimshme ose mosveprim nga ana e Prodhuesi në lidhje me këtë Marrëveshje. Pavarësisht çdo gjëje që kundërshtohen në përmbajtjen e fjalisë së mësipërme, asgjë në Nenin 25.4 nuk do zbatohen për ndonjë Humbje në lidhje me dhe në masën në të cilën Blerësi pranon të ardhura nga polica e sigurimit ose dëmshpërblim nga pala tjetër.
- 25.5 Çdo gjobë ose dënime tjera të shkaktuara nga Pala për mospërputhje me Legjislacionin në fuqi në Kosovë, përveç nëse nuk rezultojnë nga veprimi ose mosveprimi i Palës tjetër (në këtë rast, ata do të rimbursohen nga Pala tjetër), nuk do të rimbursohen nga Pala tjetër por do të jetë përgjegjësi e vetme e Palës mospërputhëse.
- 25.6 Pala dëmshpërbllyese ka të drejtë, me zgjedhje dhe shpenzime të veta dhe me avokat sipas përzgjedhjes së vetë, të marrë dhe të kontrolloj mbrojtjen e një kërkesë, veprimi, padie ose procedimi të tillë me shpenzime të veta, me një avokat sipas përzgjedhjes së vetë, subjekt i miratimit paraprak të Palës së dëmshpërbllyer; me kusht që jep një njoftim të menjëhershëm për qëllimin për të bërë një gjë të tillë për Palën e dëmshpërbllyer, dhe të rimburoj Palën e dëmshpërbllyer për kostot dhe shpenzimet e shkaktuara nga Pala e dëmshpërbllyer para supozimit nga Pala dëmshpërbllyese për një mbrojtje të tillë.
- 25.7 Përveç nëse dhe derisa Pala dëmshpërbllyese i pranon me shkrim obligimet e veta për të dëmshpërbllyer Palën e dëmshpërbllyer dhe merr kontrollin e mbrojtjes së kërkesës, padisë, veprimit ose procedimit në përputhje me Nenin 25.6, Pala e dëmshpërbllyer do të ketë të drejtën, por jo edhe obligim, të kundërshtoj, mbroj dhe mbroj me gjyq, me avokat të përzgjedhur vetë, çdo kërkesë, padi ose procedim nga ndonjë palë e tretë, të dyshuar ose pohuar kundër një Pale të tillë në lidhje me, që rezulton nga, lidhur ose ngritur nga ndonjë çështje për të cilën ka të drejtë të dëmshpërblehet, dhe kostot dhe shpenzimet e arsyeshme do jenë subjekt i obligimeve të dëmshpërblimit të Palës dëmshpërbllyese.
- 25.8 Pas sipozimit nga Pala dëmshpërbllyese të kontrollit të mbrojtjes së kërkesës, padisë, veprimit ose procedimit, Pala dëmshpërbllyese do të rimburoj Palën e dëmshpërbllyer për kostot dhe shpenzimet e arsyeshme të palës së dëmshpërbllyer në mbrojtje të kërkesës, padisë, veprimit ose procedimit para pranimit të Palës dëmshpërbllyese të dëmshpërblimit dhe marrjes së mbrojtjes.
- 25.9 Asnjëra Palë nuk ka të drejtë të zgjidhë ose të bëj kompromis për kërkesë, veprim, padi ose procedim të tillë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, me kusht që pas

pranimit me shkrim për të dëmshpërblyer Palën e dëmshpërblyer, Pala dëmshpërblyese mund të zgjidh dhe bëj kompromis për ndonjë kërkesë pa miratimin e Palës së dëmshpërblyer.

- 25.10 Pas pranimit të dëmshpërblimit dhe supozimi të mbrojtjes nga Pala dëmshpërblyese, Pala e dëmshpërblyer do të ketë të drejtë të punësoj avokatin e vetë, dhe avokati i tillë ka të drejtë të marrë pjesë në një veprim të tillë, por pagesat dhe shpenzimet e një avokati të tillë do të jenë një shpenzim për një Pale të tillë të dëmshpërblyer, kur dhe në momentin kur ndodh, përveç nëse (i) punësimi i avokatit nga Pala e tillë e dëmshpërblyer është autorizuar me shkrim nga Pala dëmshpërblyese, (ii) Pala e dëmshpërblyer arsyeshëm ka ardhur në përfundim se mund të ketë konflikt interesi në mes të Palës dëmshpërblyese dhe Palës së dëmshpërblyer në kryerjen e mbrojtjes së një veprimi të tillë, (iii) Pala dëmshpërblyese në fakt nuk është dashur të punësoj një avokat të pavarur që është arsyeshëm i kënaqshëm për Palën e dëmshpërblyer për të marrë mbrojtjen e veprimit të tillë dhe njëjtë është dashur të jetë njoftuar nga Pala e dëmshpërblyer, ose (iv) Pala e dëmshpërblyer është dashur të vijë në një përfundim të arsyeshëm dhe veçanërisht të ketë njoftuar Palën dëmshpërblyese ose që mund të ketë mbrojtje të veçantë në dispozicion që është ndryshe nga ose shtesë përtej atyre që janë në dispozicion të Palës dëmshpërblyese ose që mund të përfshihet në një kërkesë, veprim, padë ose procedim i tillë ose mund të ketë efekt material negativ në të përtej fushëveprimit të kësaj Marrëveshje. Nëse Neni (ii), (iii) ose (iv) i fjalive në vijim do jetë i aplikueshëm, atëherë avokati i Palës së dëmshpërblyer do të ketë të drejtën në mbrojtje direkte të kërkesës, veprimit, padisë ose procedimit të tillë në emër të Palës së dëmshpërblyer dhe pagesat dhe shpagimi e arsyeshëm i një avokati të tillë përbëjnë shpenzime ligjore ose tjera.
- 25.11 Secila Palë do të njoftoj menjëherë Palën tjetër për ndonjë Humbje, kërkesë, procedim ose çështje tjetër në lidhje me të cilën është apo mund të ketë të drejtë për dëmshpërblim sipas Nenit 25. Një njoftim i tillë duhet të jepet sa më shpejt që të jetë arsyeshëm praktike pasi që Pala relevante është vënë në dijeni për Humbje, kërkesë, procedim apo çështje tjetër të tillë.

26. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIONET

26.1 Në këtë mënyrë Prodhuesi përfaqëson dhe garanton Blerësin se:

- (a) Prodhuesi është i organizuar në mënyrë të rregullt, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe në gjendje të mirë sipas Legjislacionit të Kosovës, aq sa është e rëndësishme për Blerësin, dhe në përputhje të plotë me Legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- (b) Prodhuesi ka fuqi të plotë të korporatës dhe autoritet për të ekzekutuar dhe paraqitur këtë Marrëveshje, dhe për të pasur në pronësi pronat e veta dhe për të ekzekutuar, të dhënë dhe kryej obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshje. Ekzekutimi, shpërndarja dhe kryerja e kësaj Marrëveshje nga Prodhuesi, (i) është e autorizuar si duhet me të gjitha veprimet e kërkuara të korporatës nga ana e Prodhuesit, dhe asnjë procedim nga ana e Prodhuesit ose ndonjë Person tjetër nuk janë të nevojshme për një autorizim të tillë, dhe (ii) nuk do të (A) shkelë (1) Legjislacionin e Kosovës ose (2) ndonjë dispozitë të ndonjë

dokumenti të inkorporuar, ose (B) të shkelë, ose të jetë në konflikt me, të rezultojë në shkelje ose të përbëjë (me njoftimin e duhur ose kalimin e kohës ose të dyja) një mospërputhje nën ndonjë shantazh, marrëveshje për para të huazuara, lidhje, policë, instrument ose marrëveshje tjetër në të cilën Prodhuesi është Palë ose me të cilën Blerësi ose prona e tij është e lidhur, duke përjashtuar mospërmbushjet ose shkeljet të cilat nuk do të, individualisht ose së bashku, kishin efekt negativ material në biznes, prona, kushte financiare ose rezultate të operimit të Prodhuesit ose në aftësinë për të kryer obligimet sipas kësaj Marrëveshje

- (c) Duke supozuar që përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për Prodhuesin, kjo Marrëveshje përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për Prodhuesin, të zbatueshëm kundrejt tij në përputhje me kushtet e veta, subjekt i (i) falimentimit, paaftësi për të paguar, riorganizim, moratorium, ose ligje të ngjashme tani ose tash e tutje në fuqi që lidhen me të drejtat e kreditorëve, dhe (ii) parimeve të përgjithshme të barazisë.
- (d) Pas kërtimeve të arsyeshme, me dijeninë më të mirë, asnjë deklarament ose regjistrim me, asnjë njoftim dhe leje, autorizim, Pëlqim ose miratim të ndonjë Personi nuk kërkohet për ekzekutimin, dorëzimin dhe kryerjen e kësaj Marrëveshje nga Prodhuesi.
- (e) Prodhuesi nuk është në mospërmbushje me çfarëdo marrëveshje ose instrument të çfarëdo natyre në të cilën është Palë ose me të cilën është i lidhur, në çfarëdo mënyre që do të kishte efekt negativ material në aftësinë e tij për të kryer obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshje, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshje .
- (f) Nuk ka asnjë veprim, padi, procedim ose hetim në pritje ose, me dijeninë e Prodhuesit, kërcënim, (i) për shpërbërje të Prodhuesit, ose (ii) kundër Prodhuesit i cili, nëse vërtetohet e kundërta, do të kishte efekt negativ material në kryerjen e obligimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshje.

26.2 Prodhuesi, pas kërkesës nga Blerësi, të dorëzoj ose të shkaktoj dorëzimin kohë pas kohe të certifikatave të zyrtarëve, kontabilistëve, inxhinierëve, ose agjentëve të Blerësit sa i përket kryerjes së obligimeve sipas kësaj Marrëveshje, në lidhje me përputhshmërinë e Gjeneratorit me dispozitat e kësaj Marrëveshje, dhe për çështje tjera që Blerësi arsyeshëm mund të kërkoj; me kushte që Blerësi do ketë të drejtën vetë të kërkoj çdo certifikatë nga kontabilistët, inxhinierët ose agjentët e tillë brenda një periudhe dymbëdhjetë (12) Mujore.

26.3 Në këtë mënyrë Blerësi përfaqëson dhe garanton se:

- (a) Është i inkorporuar si duhet sipas Legjislacionit të Kosovës, dhe ka, aq sa është e rëndësishme për Prodhuesin, qenë në përputhje të plotë me Legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- (b) Blerësi ka fuqi të plotë të korporatës dhe autoritet për të ekzekutuar dhe paraqitur këtë Marrëveshje, dhe për të pasur në pronësi pronat e veta dhe për të ekzekutuar, të dhënë dhe kryej obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshje.

Ekzekutimi, shpërndarja dhe kryerja e kësaj Marrëveshje nga Blerësi, (i) është e autorizuar si duhet me të gjitha veprimet e kërkuara të korporatës nga ana e Blerësit, dhe asnjë procedim nga ana e Blerësit ose ndonjë Person tjetër nuk janë të nevojshme për një autorizim të tillë, dhe (ii) nuk do të (A) shkelë (1) Legjislacionin e Kosovës ose (2) ndonjë dispozitë të ndonjë dokumenti të inkorporuar, ose (B) të shkelë, ose të jetë në konflikt me, të rezultojë në shkelje ose të përbëjë (me njoftimin e duhur ose kalimin e kohës ose të dyja) një mospërputhje nën ndonjë shantazh, marrëveshje për para të huazuara, lidhje, policë, instrument ose marrëveshje tjetër në të cilën Blerësi është Palë ose me të cilën Blerësi ose prona e tij është e lidhur, duke përjashtuar mospërmbushjet ose shkeljet të cilat nuk do të, individualisht ose së bashku, kishin efekt negativ material në biznes, prona, kushte financiare ose rezultate të operimit të Blerësit ose në aftësinë për të kryer obligimet sipas kësaj Marrëveshje.

- (c) Duke supozuar që përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyruës për Prodhuesin, kjo Marrëveshje përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyruës për Blerësin, të zbatueshëm kundrejt tij në përputhje me kushtet e veta, subjekt i (i) falimentimit, paaftësi për të paguar, riorganizim, moratorium, ose ligje të ngjashme tani ose tash e tutje në fuqi që lidhen me të drejtat e kreditorëve, dhe (ii) parimeve të përgjithshme të barazisë.
- (d) Pas kërkimeve të arsyeshme, me dijeninë më të mirë, përveç për miratimet që veç janë dhënë ose marrë, asnjë deklarament ose regjistrim me, asnjë njoftim dhe leje, autorizim, Pëlqim ose miratim të ndonjë Personi nuk kërkohet për ekzekutimin, dorëzimin dhe kryerjen e kësaj Marrëveshje nga Blerësi.
- (e) Prodhuesi nuk është në mospërmbushje me çfarëdo marrëveshje ose instrument të çfarëdo natyre në të cilën është Palë ose me të cilën është i lidhur, në çfarëdo mënyre që do të kishte efekt negativ material në aftësinë e tij për të kryer obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshje, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshje.
- (f) Nuk ka asnjë veprim, padi, procedim ose hetim në pritje ose, me dijeninë e Blerësit, kërcënim, (i) për shpërbërje të Blerësit, ose (ii) kundër Blerësit i cili, nëse vërtetohet e kundërta, do të kishte efekt negativ material në kryerjen e obligimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshje.

26.4 Prodhuesi nuk do të ngacmoj (manipuloj), dhe do të sigurohet që punonjësit, kontraktorët ose nënkontraktorët e tij të çdo shtrese nuk do të ngacmojnë, Sistemin Matës. Nëse Prodhuesi shkelë marrëveshjen paraprirëse, Prodhuesi duhet të (a) ndërmarrë të gjithë hapat rregullues që janë arsyeshëm të pranueshëm për Blerësin për t'u siguruar se një ngacmim i tillë nuk përsëritet, duke përfshirë zhvillimin ose shtimin e sistemeve të sigurisë, dhe (b) kompensoj Blerësin për dy (2) herë shumën ose shumën e vlerësuar arsyeshëm të ndonjë pagese të tepërt nga Blerësi që ka rezultuar nga një ngacmim i tillë, e cila për qëllime të përcaktimit të tillë do të supozohet se ka ndodhur menjëherë pas testit të njohur të saktë të fundit të Sistemit Matës, (përveç nëse Prodhuesi demonstroi aq sa për të kënaqur arsyeshëm Blerësin se ngacmimi nuk ka ndodhur deri në një datë të mëvonshme, në të cilin rast ajo datë e mëvonshme do të përdoret si referencë për përcaktimin e shumës së tillë). Palët janë pajtuar se shumën e

një kompensimi të tillë përbën dëme të likuidueshme për Blerësin për çdo shkelje të tillë dhe do të jetë kompensimi i vetëm për Blerësin. Prodhuesi heq dorë, në masën më të madhe të lejuar nga ligji, nga çdo kërkesë se një kompensim i tillë është i pavlefshëm si një dënim.

27. TATIMET

- 27.1 Të gjitha Tatimet e tanishme dhe në të ardhme të zbatueshme për Prodhuesin, Gjeneratorin, dhe asetet tjera të Prodhuesit do të paguhen nga Prodhuesi si dhe kur kërkohen sipas Legjislacionit të Kosovës.
- 27.2 Të gjitha Tatimet e tanishme dhe në të ardhmen të zbatueshme për Blerësin, që dalin nga ose në lidhje me të drejtat dhe obligimet sipas kësaj Marrëveshje do të paguhen nga Blerësi si dhe kur të kërkohen sipas Legjislacionit të Kosovës.

28. POHIMI

- 28.1 Prodhuesi deklaron se nuk e ka marrë ose nxitur blerjen e kësaj Marrëveshje ose të ndonjë kontrate, pëlqimi, miratimi, të drejte, interesi, privilegji ose obligimi tjetër ose përfitimi që lidhet me këtë Marrëveshje ose Projekt nga Blerësi përmes ndonjë praktike biznesore korruptuese ose ilegale.
- 28.2 Prodhuesi pranon përgjegjësinë e plotë dhe detyrimin e ashpër për ndonjë deklaratë të rreme, mos zbulimin e plotë, shtrembërim faktesh ose ndërmarrje të ndonjë veprimi që me gjasë mposht qëllimin e përfaqësimeve dhe garancioneve të përfshira në këtë dokument dhe deklaratave të kërkuara me këtë rast. Pajtohet që çdo kontratë, pëlqim, miratim, e drejtë, interes, privilegj ose obligim tjetër ose përfitim i marrë ose i siguruar siç është thënë më sipër do të, pa paragjykim në ndonjë të drejtë dhe kompensim që është në dispozicion për Blerësin, jetë i anulueshëm dhe pa ndonjë efekt ligjor për variantin e Blerësit.
- 28.3 Pavarësisht nga të drejtat dhe mjetet juridike që janë në dispozicion për dhe mund të ushtrohen nga Blerësi në këtë drejtim, Prodhuesi pajtohet të dëmshpërblej Blerësin për çdo humbje ose dëm të shkaktuar nga ai në lidhje me praktikën e tij korruptive të biznesit dhe për më tepër të paguaj kompensimin për Blerësin në shumë ekuivalente me dhjetë (10) herë shumën e ndonjë komisioni, kënaqësie, ryshfeti, tarifa e gjetësit haraçi i paguar ose dhënë nga Prodhuesi (çoftë direkt apo indirekt përmes çdo personi fizik ose juridik, duke përfshirë anëtarët e organizatës, punonjësit, agjentët, bashkëpunëtorët, komisionarët, konsulentët, zyrtarët, drejtorët, promotorët, aksionarët, sponsorët ose filialet (dhe punonjësit, agjentët, bashkëpunëtorët, komisionarët, konsulentët, zyrtarët, drejtorët, promotorët, aksionarët, sponsorët e tyre)), siç është thënë më sipër me qëllim të marrjes ose bindjes së prokurimit të kësaj Marrëveshje ose të ndonjë kontrate, pëlqimi, miratimi, të drejte, interesi, privilegji ose obligimi tjetër ose përfitimi që lidhet me këtë Marrëveshje ose Projekt nga Blerësi.

29. NUK KA PËRGJEGJËSI PËR TË RISHQYRTUAR

- 29.1 Asnjë shqyrtim dhe miratim nga Blerësi për ndonjë marrëveshje, dokument, instrument, vizatim, specifikime, ose dizajn të propozuar nga Prodhuesi e as ndonjë inspektim i Stabilimenteve Kyçëse të Prodhuesit të bërë nga Blerësi sipas kësaj Marrëveshje nuk do të liroj Prodhuesin nga çdo përgjegjësi që përndryshe do të kishte për neglizhencën e tij në përgatitjen e marrëveshjes, dokumentit, instrumentit, vizatimit, ose dizajnit të tillë ose kryerjes së punëve të tilla ose dështimit për të qenë në përputhje me Legjislacionin në fuqi në Kosovë në lidhje me këto, ose për të përmbushur obligimet Prodhuesit sipas kësaj Marrëveshje e as Blerësi nuk do jetë përgjegjës nga Prodhuesit ose ndonjë Personi tjetër për arsye të shqyrtimit apo miratimit të tij të një marrëveshje, dokumenti, instrumenti, vizatimi, specifikimi ose dizajn ose një inspektim i tillë.

30. FSHEHTËSIA

- 30.1 Secila palë duhet ta trajtojë si konfidenciale dhe nuk duhet të, pa pëlqim paraprak me shkrim të Palës tjetër, zbulojë informata të marra si rezultat i hyrjes në ose kryerjes së kësaj Marrëveshje, të cilat lidhen me këtë Marrëveshje ose negociatat që lidhen me këtë Marrëveshje. Neni 30.1 nuk është i zbatueshëm për rrethanat e përshkruara në Nenin 30.2.
- 30.2 Secila palë mund të zbulojë informata të cilat, në bazë të Nenit 30.1 përndryshe do të ishin të fshehta nëse dhe deri në atë masë sa kërkohen me ligj; ose nëse dhe deri në atë masë sa kërkohen me rregullat e ndonjë organi rregullativ ose këmbimi të letrave me vlerë ose organ qeveritar ose agjenci ndaj të cilës ajo Palë ose Anëtarë të Organizatës e saj janë subjekt.
- 30.3 Kufizimet në Nenin **Error! Reference source not found.** do të vazhdojnë të zbatohen pas shkëputjes ose skadimit të kësaj Marrëveshje pa kufizim në kohë.

31. NJOFTIMET

- 31.1 Me përjashtim të ndonjë Udhëzimi për Dispeçim dhe komunikimi në mes të Prodhuesit dhe Blerësit në lidhje me Dispeçim të Gjeneratorit, të gjitha njoftimet dhe komunikimi tjetër i kërkuar ose lejuar që të jepet nga një Palë duhet të jetë me shkrim dhe ose të dorëzohet personalisht ose me postë ose të dërgohet me faks në adresën dhe numrin e Palës tjetër të specifikuar më poshtë. Emaili mund të përdoret si një metodë shtesë e njoftimit vetëm për njoftime.

Blerësi

Adresa:

[●]

Për vëmendje të: [●]

E-mail: [●]

Numri i tel: [●]

Numri i faks: [●]

Prodhuesi

Adresa:

[●]

Për vëmendje të: [●]

E-mail: [●]

Numri i tel: [●]

Numri i faks: [●]

Duke parashikuar që Pala mund të ndërroj adresën në të cilën do të dërgohen njoftimet duhet të jap njoftim paraprak me shkrim prej jo më pak se tridhjetë (30) Ditë tek Pala tjetër në përputhje me Nenin 31.1

31.2 Asnjë njoftim ose komunikim nuk do të merret si efektiv përderisa nuk pranohen ose konsiderohet i pranuar. Njoftimet dhe komunikimet do të duhet të konsiderohen të pranuar nga Pala pranuese:

- (a) kur të dorëzohen nëse dorëzohen personalisht;
- (b) një (1) Ditë Punë pas dërgimit, nëse dërgohet me postë; ose
- (c) pas dërgimit me faks, subjekt i konfirmimit të një raporti të transmetimit të pandërprerë dhe me kusht që një kopje e shtypur është Dërguar jo më vonë se Ditën e ardhshme të Punës tek marrësi përmes postës ose dërgim personal.

Udhëzimet e Dispeçimit dhe komunikimet në mes të Prodhuesit dhe Blerësit në lidhje me Dispeçimin e Gjeneratorit mund të jepen edhe përmes komunikimit me telefon ose ndonjë formë tjetër e komunikimit të cilën Palët pajtohen ta përdorin. Detajet e një komunikimi të tillë do të jepen nga secila Palë para Datës së Operimeve Komerciale në përputhje me Nenin 7.2

31.3 Të gjitha komunikimet në mes të Palëve do të jenë në gjuhën Shqipe ose gjuhën Angleze. Në rast se ka ndonjë konflikt në mes të versionit në gjuhën Shqipe dhe Angleze të një komunikimi të tillë, versioni në gjuhën Shqipe do të mbizotërojë.

32. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME

32.1 Nëse në çdo kohë dispozita e kësaj Marrëveshje bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në çdo aspekt sipas ligjit të ndonjë juridiksioni, as vlefshmëria ose zbatueshmëria e dispozitës së tillë sipas ligjit të çdo juridiksioni tjetër as ligjshmëria, vlefshmëria ose zbatueshmëria e ndonjë dispozite tjetër nuk do të ndikohet ose dëmtohet në asnjë mënyrë.

32.2 Paligjshmëria, invaliditeti ose pazbatueshmëria e ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshje si e tërë ose një pjesë të saj sipas ligjit të ndonjë juridiksioni nuk duhet të ndikoj as në (i) ligjshmëri, vlefshmëri ose zbatueshmëri të saj sipas ligjit të ndonjë juridiksioni tjetër, e as (ii) ligjshmëria e ndonjë dispozite tjetër ose pjesë të ndonjë dispozite.

33. HEQJA DORË

- 33.1 Asnjë mospërmbushje nga cilado Palë në performancë të ose pajtueshmëri me ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshje nuk do të hiqet dorë ose hiqet përveç nëse ka pëlqim të shprehur me shkrim të Palës tjetër. Asnjë heqje dorë nga cilado Palë e ndonjë mospërmbushje nga tjetri në performancë të ose pajtueshmëri me ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshje nuk do operoj ose të interpretohet si heqje dorë nga tjerat ose të ketë mospërmbushje të mëtejme çoftë me dëshirë ose të një karakteri tjetër.
- 33.2 Ushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, fuqie ose rregullimi të dhënë me ligj ose sipas kësaj Marrëveshje nuk do të pengojë ushtrimin e ndonjë tjetre në të ardhmen ose ushtrimin e ndonjë të drejte, fuqie ose rregullimi tjetër.

34. FORCA MADHORE

34.1 Një “Ngjarje e Forcës Madhore” do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë ose kombinim i ngjarjeve ose rrethanave (duke përfshirë efektin e tyre) që është përtej kontrollit të arsyeshëm të Palës dhe se në ose pas Datës Efektive, materialisht ose negativisht ndikon në performancës e palës së tillë të dëmtuar të obligimeve të saj sipas ose në përputhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë aftësinë e Palës për të liferuar ose pranuar energji nga Gjeneratori); me kusht që efekti i tillë material ose negativ nuk ka mundur të parandalohet, tejkalohet ose rregullohet plotësisht ose pjesërisht nga Pala e prekur përmes ushtrimit të kujdesit të zellshëm dhe të arsyeshëm, duke e kuptuar atë dhe dakorduar se kujdesi i arsyeshëm përfshinë veprimet dhe aktivitetet për mbrojtjen e Gjeneratorit nga një aksident ose ngjarje tjetër; që janë të arsyeshme duke marrë parasysh probabilitetin e shfaqjes së një ngjarje të tillë, efektin e mundshëm të një ngjarje të tillë nëse do të ndodhte, dhe efikasitetin e mundshëm të masave mbrojtëse. “Ngjarja e Forcës Madhore” pra do të përfshijë secilën nga ngjarjet dhe rrethanat në vijim (duke përfshirë efektin e tyre), por vetëm në atë mase që secila prej tyre përmbush kërkesat e mësipërme:

- (a) Ngjarjet politike të mëposhtme që ndodhin brenda ose direkt përfshijnë Kosovën (secila një “Ngjarje Politike në Kosovë”, dhe deri në një masë gjithashtu Ngjarje e Forcës Madhore, një “Ngjarje e Forcës Madhore Politike në Kosovë” ose “NFMPK”):
- (i) çdo akt lufte (çoftë i deklaruar ose i padeklaruar), pushtim, konflikt i armatosur ose veprim i armikut të huaj, bllokadë, embargo, revolucion, trazira, kryengritje, rebelim civil, ose vepër ose fushatë terroriste ose sabotim politik; ose
 - (ii) çdo Përfundim i Pëlqimit që është dashur të ekzistoj për tridhjetë (30) Ditë të njëpasnjëshme ose më shumë; ose
 - (iii) çdo grevë, punë minimale sipas rregullave, punë të ngadalshme, ose veprim analog i punës që është politikisht i motivuar dhe është i përhapur ose në tërë vendin.
- (b) Ngjarje të tjera jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës së prekur (secila “Ngjarje tjetër e Forcës Madhore”), duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- (i) rrufe, zjarr, ose termet; ose
 - (ii) çdo Përfundim i Pëlqimit që është dashur të ekzistoj për tridhjetë (30) Ditë të njëpasnjëshme ose më shumë; ose
 - (iii) çdo grevë, punë minimale sipas rregullave, punë të ngadalshme, ose veprim analog i punës që është politikisht i motivuar dhe është i përhapur ose në tërë vendin; ose
 - (iv) zjarr, eksplozim, ndotje kimike, ndotje radioaktive, ose rrezatim jonizues; ose
 - (v) epidemi ose murtajë.
- (c) Ngjarjet e Forcës Madhore shprehimisht nuk duhet të përfshijnë kushtet e mëposhtme, përveç dhe deri në atë masë sa ngjarjet ose rrethanat e tilla ndodhin direkt ose si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore:
- (i) liferim i vonuar ose ndërprerje e liferimit të makinerisë, materialeve të pajisjeve, pjesëve rezervë ose pjesëve shpenzuese; ose
 - (ii) konsumimi normal ose të metat e rastit në materiale dhe pajisje ose prishja në pajisje.

34.2 Nëse për arsye të Ngjarjes së Forcës Madhore një Palë është plotësisht ose pjesërisht e paaftë për të kryer obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshje, Pala e prekur do të:

- (a) japë një njoftim për Palën tjetër rreth Ngjarjes(eve) së Forcës Madhore sa më shpejt që të jetë praktike, por në çdo rast, jo më vonë se dyzetë e tetë (48) orë pasi që Pala e prekur është e vetëdijshme për shfaqjen e Ngjarjes(eve) së Forcës Madhore ose njëzet e katër (24) orë pas rifillimit të mënyrave të dhënies së njoftimeve në mes të Prodhuesit dhe Blerësit, dhe
- (b) jep Palës tjetër njoftimin e dytë, ku përshkruan Ngjarjen(et) e Forcës Madhore në detaje të arsyeshme dhe, deri në atë masë sa mund të përcaktohen arsyeshëm në kohën e dhënies së njoftimit të tillë, duke dhënë një vlerësim preliminar të obligimeve të prekura, vlerësimin preliminar të periudhës kohore që Pala e prekur nuk do të jetë në gjendje të kryej obligimet e tilla dhe çështje tjera relevante sa më shpejt që të jetë praktike, por në çdo rast, jo më vonë se shtatë (7) Ditë pas njoftimit fillestar për shfaqjen e Ngjarjes(eve) së Forcës Madhore që është dhënë nga Pala e prekur. Atëherë kur është e përshtatshme ose arsyeshëm e kërkuar që të bëhet nga Pala tjetër, Pala e prekur do të siguroj njoftime shtesë për Palën tjetër duke shpjeguar më shumë Ngjarjen(et) e Forcës Madhore dhe çfarë ka shkaktuar dhe duke dhënë dhe azhurnuar informata në lidhje me përpjekjet e Palës së prekur për të shmangur dhe/ose lehtësuar efektin(et) e saj dhe vlerësimet, deri në atë masë sa është praktike, të kohës kur Pala e prekur pret arsyeshëm të jetë në gjendje të vazhdoj ndonjë prej obligimeve të ndikuara për shkak të Ngjarjes(eve) të Forcës Madhore.

34.3 Pala e prekur duhet të njoftoj Palën tjetër:

- (a) në lidhje me Ngjarjen e Forcës Madhore që është duke vazhduar, të ndërprerjes së Ngjarjes së Forcës Madhore, dhe

- (b) aftësisë së tij për të rifilluar kryerjen e obligimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se shtatë (7) Ditë pas shfaqjes së Nenit (a) më sipër.
- 34.4 Dështimi i Palës së prekur për të dhënë një njoftim për Ngjarjen e Forcës Madhore tek Pala tjetër brenda periudhës dyzet e tetë (48) orëshe ose periudhës njëzetë e katër (24) orëshe të kërkuar sipas Nenit 34.2 nuk do të ndaloj Palën e prekur për të dhënë një njoftim të tillë më vonë; me kusht që në rast të tillë Pala e prekur nuk do të arsyetohet sipas Nenit 34.6 për ndonjë dështim apo vonesë në përmbushjen e obligimeve sipas ose në përputhje me këtë Marrëveshje derisa një njoftim i tillë të jetë dhënë. Nëse njoftimi në fjalë është dhënë brenda periudhës dyzetë e tetë (48) orëshe ose periudhës njëzet e katër (24) orëshe siç kërkohen nga Neni 34.2, Pala e prekur do të arsyetohet për një dështim ose vonesë të tillë në pajtim me Nenin 34.6 nga data e fillimit të Ngjarjes së Forcës Madhore.
- 34.5 Pala e prekur do të përdorë të gjitha përpjekjet e arsyeshme (ose do të sigurohet që Kontraktorët e tij do përdorin të gjitha përpjekjet e arsyeshme) për të zbutur efektet e Ngjarjes së Forcës Madhore, duke përfshirë, por jo kufizuar në, pagesën e shumë së arsyeshme të parave nga ose në emër të Palës së prekur (ose Kontraktorëve të tillë), shumën të cilat janë të arsyeshme sa i përket efikasitetit të mundshëm të masave zbutëse.
- 34.6 Subjekt ndaj Nenit 34.4, për sa kohë që Pala e prekur në çdo kohë që nga shfaqja e Ngjarjes së Forcës Madhore ka respektuar obligimet e Nenit 34.2 dhe vazhdon ti respektoj ato (i) Pala e prekur nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dështim apo vonesë në kryerjen e obligimeve të tij (përveç ndonjë obligim për të bërë pagesë ose ofrojë siguri) sipas dhe në pajtim me këtë Marrëveshje gjatë ekzistencës së Ngjarjes së Forcës Madhore dhe (ii) çdo afat të fundit të performancës së Pala e prekur është e obliguar ta përmbushë sipas kësaj Marrëveshje duhet të zgjatet; me kusht që asnjë lehtësim, përfshirë zgjatjen e afatit të fundit, nuk do të jepet për Palën e prekur sipas Nenit 34.6 deri në atë masë sa një dështim ose vonesë e tillë megjithatë do të ndodhte nga Pala e prekur edhe po të mos ndodhte Ngjarja e Forcës Madhore; me kusht që në rast se Ngjarja e Forcës Madhore e cila ka dëmtuar Gjeneratorin, në asnjë rast obligimet e Palës së prekur sipas kësaj Marrëveshje për të përmbushur kryerjen afatet kohore të performancës nuk do të zgjaten më shumë se dy (2) vjet nga data e skadimit të Afatit. Përveç për shkelje të kësaj Marrëveshje nga Pala tjetër, ose pa paragjykim për të drejtën e Palës së prekur për dëmshpërblim sipas Nenit 25 ose për pagesë sipas Nenit 8, Pala tjetër nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi për ndonjë Humbje të pësuar nga Pala e prekur si rezultat i Ngjarjes së Forcës Madhore.
- 34.7 Pas shfaqjes së Ngjarjes së Forcës Madhore pas Datës së Operimeve Komerciale, atëherë gjatë kohëzgjatjes së Ngjarjes së Forcës Madhore, Blerësi do të paguaj Pagesat e Energjisë së Prodhuesit për Neto Energjinë Elektrike të Liferuar gjatë kohëzgjatjes së një Ngjarje të tillë të Forcës Madhore që Prodhuesi është në gjendje të siguroj gjatë kohëzgjatjes së Ngjarjes së Forcës Madhore.
- 34.8 Nëse cilado Palë preket në mënyrë të tillë nga Forca Madhore për një periudhë të vazhdueshme prej më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj, mund të shkëpus këtë

Marrëveshje me njoftim me shkrim prej 30 (tridhjetë) ditësh tek Pala tjetër, një njoftim i tillë do të përfundoj në çdo kohë pas periudhës 12 mujore në fjalë.

35. NDRYSHIMET

35.1 Një ndryshim ose modifikim i kësaj Marrëveshje do të jetë efektiv dhe detyrues ndaj një Pale vetëm nëse bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës Palë.

36. PALËT E TRETA

36.1 Përveç të drejtave të dhëna shprehimisht tek palët e treta këtu, kjo Marrëveshje ka vetëm një qëllim për përfitimin e Palëve dhe asgjë në këtë Marrëveshje nuk duhet të interpretohet si krijim i të drejtën në, detyrës për të, standardin për t'u kujdesur, ose ndonjë përgjegjësi për ndonjë Person që nuk është Palë.

37. MARRËVESHJA E PLOTË

37.1 Kjo Marrëveshje përbën komplet dhe të vetmen marrëveshje në mes të Palëve në lidhje me temën në fjalë. Përveç në masën e përsëritur në këtë Marrëveshje, kjo Marrëveshje zëvendëson dhe shuan çdo Deklaratë para-kontraktuale ose ndonjë marrëveshje paraprake në lidhje me temën në fjalë.

37.2 Secila Palë pranon se hyrja në këtë Marrëveshje nuk mbështetet në ndonjë deklaratë para-kontraktuale, qoftë gojore ose me shkrim, e cila nuk është përcaktuar në këtë Marrëveshje.

38. LIGJI QEVERISËS

38.1 Kjo Marrëveshje do të qeveriset nga, interpretohet dhe shpjegohet në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës.

39. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

39.1 Në rast se ka një Mosmarrëveshje, Palët do të provojnë në mirëbesim të zgjidhin një Mosmarrëveshje të tillë përmes diskutimeve të përbashkëta brenda tridhjetë (30) Ditësh pas datës kur Pala që ka ngritur mosmarrëveshjen ka dhënë një njoftim me shkrim për atë Mosmarrëveshje tek Pala tjetër.

39.2 Pala që pohon ekzistencën e një Mosmarrëveshje do të jap një njoftim me shkrim për Palën tjetër duke përcaktuar hollësisht materiale e Mosmarrëveshjes. Pas kësaj, përfaqësuesit e lartë të Blerësit dhe Prodhuesit do të takohen në Prishtinë, Kosovë për bërë përpjekje që në mirëbesim të zgjidhin Mosmarrëveshjen.

39.3 Nëse Mosmarrëveshje nuk zgjidhet brenda tridhjetë (30) Ditëve pas datës së pranimit të njoftimit të përshkruar në Nenin 39.2 nga Pala relevante (ose brenda një afati të tillë

kohor më të gjatë për të cilin mund të pajtohen Palët), atëherë dispozitat e Nenit 39.4 do të zbatohen, sipas rastit.

- 39.4 Çdo Mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje që nuk është zgjidhur pasi që janë ndjekur procedurat e përcaktuara në Nenin 39.3 do të zgjidhet nga arbitrazhi në përputhje me rregullat UNCITRAL të arbitrazhit, siç është në fuqi në datën e kësaj Marrëveshje (“**Rregullat**”), nga një (1) arbitër i emëruar në përputhje me Rregullat. Procedurat e arbitrazhit do të zhvillohen, dhe vendimi do të jepet, në gjuhën Angleze. Selia, ose vendi ligjor, i arbitrazhit do të jetë në Prishtinë, Kosovë. Asnjë arbitër i emëruar sipas Nenit 39.4 nuk do të jetë shtetas i juridiksionit të cilësdo Palë ose i juridiksionit të ndonjë investitori që direkt ose përmes përfitimeve ka në pronësi pesë përqind (5%) ose më shumë të Aksioneve të Zakonshme Kapitale të cilësdo Palë, e një arbitër i tillë nuk do të jetë punonjës ose agjent ose ish punonjës ose agjent i Blerësit, Prodhuesit, ose ndonjë investitori që direkt ose përmes përfitimeve ka në pronësi pesë përqind (5%) ose më shumë të Aksioneve të Zakonshme Kapitale të cilësdo Palë.
- 39.5 Vendimi i gjykatës së arbitrazhit do të jetë final dhe mund të zbatohet nga secila Palë në çdo gjykatë që ka juridiksion mbi Palët.
- 39.6 Ligji qeverisës i gjykatës së arbitrazhit është Ligji i Kosovës.

40. MARRËDHËNIET E PALËVE

- 40.1 Kjo Marrëveshje nuk do të interpretohet ose shpjegohet si krijim i një shoqate, sipërmarrje të përbashkët ose partneriteti në mes të Palëve ose të imponoj ndonjë obligim partneriteti ose detyrim ndaj cilësdo Palë.
- 40.2 Asnjëra Palë nuk ka të drejtën, fuqinë, ose autoritetin që të lidh ndonjë marrëveshje ose të ndërmarrë diçka për, të veproj në emër të, ose të jetë një agjent ose përfaqësuesi, ose përndryshe të lidh, Palën tjetër, dhe asnjëra Palë nuk duhet të mbajë vetën tek palët e treta se ka të drejtë, fuqi, ose autoritet të tillë.

41. GJUHA

- 41.1 Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën Shqipe dhe Angleze dhe versioni në gjuhën Shqipe do të mbizotëroj ndaj çdo përkthimi.

42. EKZEMPLARËT

- 42.1 Kjo Marrëveshje do të bëhet në dy (2) ose më shumë kopje origjinale dhe secila kopje e tillë mund të bëhet nga secila Palë në kopje të veçantë, secila prej kopjes kur të ekzekutohet dhe dorëzohet nga Pala duhet të jetë në origjinal, por të gjitha së bashku përbëjnë një dhe të njëjtin instrument.

NË DËSHMI TË, secilës Palë që ka bërë këtë Marrëveshje që të ekzekutohet në mënyrë të rregullt dhe në emër të vetin si në datën e shkruar më sipër.

Për Blerësin

Emri:

Pozita: [●]

Nënshkrimi:

Data:

Për Prodhuesin

EMRI:

Pozita: [●]

Nënshkrimi:

Data:

SHTOJCA 1 TARIFAT PËR BLERJE TË ENERGJISË

Blerësi do të paguajë Prodhuesin për Neto Energjinë Elektrike të Liferuar nga Gjeneratori të matur në përputhje me Nenin **Error! Reference source not found.** të Marrëveshjes, Çmimi i Energjisë, i cili duhet të jetë çmim i rregulluar i përcaktuar nga ZRRE sipas Vendimit të ZRRE [• Vendimi për përcaktimin e Tarifave Nxitëse ose Vendimi për përcaktimin e Çmimit Referent].

Çmimi i Energjisë është [• €] *[me fjalë]*.

Përveç nëse është e shprehur ndryshe me shkrim nga ZRRE, Tarifa Nxitëse është çmimi neto, dhe për këtë arsye është i përjashtuar nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në Kosovë. Prandaj, fatura e dorëzuar nga Prodhuesi tek Blerësi për Pagesë të Energjisë sipas Nenit 9.2 të Marrëveshjes duhet gjithashtu të listoj TVSH-në ndaras dhe në normën mbizotëruese për pagesë nga Blerësi për Prodhuesin.

SHTOJCA 2

PËRSHKRIMI I KOMPLEKSIT

[•]

SHTOJCA 3 PIKA KYÇËSE

[●]

SHTOJCA 4 SIGURIMI

1. SIGURIMI NDAJ TË GJITHA RREZIQEVE – ASETET FIKSE

Mbulueshmëria: Të gjitha ndërtimet, makineritë, stoku, instalimet, montimet dhe e tërë prona personale që janë pjesë e Gjeneratorit kundrejt "Të gjitha Rreziqeve" humbjes ose dëmit fizik, përfshirë (por pa u kufizuar në) ato që rezultojnë nga zjarri, rrufeja, furtuna, stuhia, përmbytja, uragani, dëme të ujit, trazira, greva, dëmtimi me qëllim të keq përfshirë aktin terrorist dhe sabotazhin, tërmetin, cunami, kolapsi..

Shuma e siguruar: Vlera e plotë e zëvendësimit të Gjeneratorit.

I siguruari: Prodhuesi, Kontraktori O&M, dhe Blerësi.

2. PRISHJA E MAKINERISË

Mbulueshmëria: E tërë makineria, Gjeneratori dhe pajisjet ndihmëse që janë pjesë e Gjeneratorit kundrejt humbjes ose dëmit të papritur dhe parashikuar që rezulton nga prishja mekanike dhe elektrike ose çrregullimi, lidhja e shkurtë elektrike, rryma ose tensioni i tepërt, stres jonormal, forcat centrifugale, dështimi i pajisjeve mbrojtëse ose rregullative, ndikimi, përplasja dhe shkaqe tjera të ngjashme.

Shuma e siguruar: Vlera e plotë e zëvendësimit të të gjithë makinerisë, Gjeneratori etj.

I siguruari: Prodhuesi, Kontraktori O&M, dhe Blerësi.

3. PËRGJEGJËSIA PUBLIKE:

Mbulueshmëria: Përgjegjësia ligjore e të siguarit për dëmtim të pronës së palëve të treta ose lëndime trupore ndaj palëve të treta që dalin nga pronësia, operimi dhe mirëmbajtja e Gjeneratorit.

Shuma e siguruar: 1,000,000 EURO për çdo ndodhi.

I siguruari: Prodhuesi, Kontraktori O&M, dhe Blerësi.

SHTOJCA 5

KUFIZIMET TEKNIKE; PROGRAMI & TESTET E KOMISIONIMIT

Të dhënat e mëposhtme duhet të kompletohen nga Palët gjatë kryerjes së Testeve të Komisionimit, dhe të nënshkruar nga përfaqësuesit e të dy Palëve.

[●]